




Регионална платформа на западен Балкан за застапување  
на слободата на медиумите и за заштита на новинарите  
Western Balkan's Regional Platform for Advocating  
Media Freedom and Journalists' Safety

# Indikatorë për nivelin e lirisë së mediave dhe sigurinë e gazetarëve [MAQEDONIA]





**Indikatorë për  
nivelin e lirisë  
së mediave  
dhe sigurinë  
e gazetarëve  
[MAQEDONIA]**

**Autorë:  
Besim Nebiu  
Naser Selmani  
Dragan Sekullovski  
Nikolla Naumovski  
Dhjetor viti 2017**

Indikatorë për nivelin e lirisë së mediave  
dhe sigurinë e gazetarëve [MAQEDONIA]

Publikues  
Shoqata e Gazetarëve të Maqedonisë



Gradski zid blok 13, 1000 Shkup, Republika e Maqedonisë  
Tel. +389 (0)2 3298-139  
Faks +389 (0)2 3116-447  
[www.znm.org.mk](http://www.znm.org.mk)

Besim Nebiu, Naser Selmani, Dragan Sekullovski dhe Nikolla Naumovski.

Lektor  
Vanja Dimitrova

Dizajni grafik  
comma | communications design

Ky publikim është hartuar me ndihmën e Bashkimit Evropian. Përmbajtja e publikimit është përgjegjësi e vetëm e Shoqatës së pavarur të gazetarëve të Serbisë dhe të autorëve dhe në asnjë mënyrë nuk mund të konsiderohet se shpreh pikëpamjet e Bashkimit Evropian.

<b>Rezyme</b>	<b>5</b>		
Indikatori A: Siguria juridike e lirisë së mediave	6	B.4. Cili është niveli i pavarësisë së gazetarëve në sektorin jo fitimprurës?	22
Indikatori B: Pozita e gazetarëve në redaksi, etika profesionale dhe niveli i censurës	7	B.5. Sa kanë liri gazetarët në procesin e prodhimit të lajmeve?	23
Indikatori C: Siguria e Gazetarëve	7	<b>C. Siguria dhe statistika e mosndëshkimit</b>	<b>25</b>
		C1. Statistika për siguri dhe mosndëshkim	26
<b>A. Mbrojtja Juridike e Lirisë së Mediave</b>	<b>9</b>	C.2. A marrin përgjegjësi aktorët politik dhe institucionet shtetërore për mbrojtjen e gazetarëve?	29
A.1. A siguron legjislativi vendor garanca për lirinë e mediave dhe të njëjtat a zbatohen në mënyrë efikase në praktikë?	10	C.3. A funksionon sistemi gjyqësor penal dhe civil në mënyrë efektive me kërcënimet dhe dhunën kundër gazetarëve?	30
A.2. A shkaktojnë efekt frike tek gazetarët Ligjet për shpifje?	13	<b>Shtesë</b>	<b>32</b>
A.3. A ekziston mbrojtje e mjaftueshme e pluralizmit politik në media, para dhe gjatë fushatë zgjedhore?	14	Lista e personave të intervistuar	32
A.4. A garantohet me ligj liria e punës së gazetarisë dhe shoqatës dhe a zbatohet ligji i tillë?	15	<b>Bibliografi</b>	<b>33</b>
A.5. Në çfarë niveli është mbrojtja juridike e burimeve të gazetarëve?	16	Dokumente juridike	33
A.6. Cili është niveli i mbrojtjes të së drejtës për qasje deri tek informatat me karakter publik?	17	Dokumente për politikë	34
		Publikime	34
		Tekste online	34
<b>B. Pozita e gazetarëve në redaksi, etika profesionale dhe niveli i censurës</b>	<b>19</b>		
B. 1.A keqpërdoret pozita ekonomike e gazetarëve për ta kufizuar lirinë e tyre?	20		
B.2. Cili është niveli i pavarësisë redaktuese nga pronarët e mediave dhe organeve drejtuese?			
B.3. Cili është niveli i pavarësisë redaktuese të gazetarëve në servis publik?	21		
	22		



Ky studim e analizon gjendjen e lirisë së shprehjes dhe të mediave në Maqedoni, në mënyrë të detajuar, edhe atë për tre muajt e fundit të vitit 2016 dhe nëntë muajt e parë të vitit 2017. Në këtë studim, analizohet korniza ligjore lidhur me lirinë e shprehjes, pozitën socio-ekonomike dhe sigurinë e gazetarëve. Kjo rezime paraqet vazhdimi të publikimit të vitit të kaluar të SHGM-së me titull “Indikatorë për nivelin e lirisë së mediave dhe sigurinë e gazetarëve në Maqedoni”.

Qëllimi kryesor i këtij hulumtimi të dytë është që ti identifikojë ndryshimet dhe të bëjë krahasim me liritë mediatike dhe sigurinë e gazetarëve gjatë vitit 2016.

Në këtë dokument janë identifikuar problemet dhe sfidat kyçe si dhe jepen rekomandime se çfarë masash duhet të ndërmerren për ta përmirësuar gjendjen në sektorin mediatik në Maqedoni.

Për nevojat e këtij studimi janë përdorur metoda të ndryshme kualitative dhe kuantitative me qëllim që të mblihdhen dhe analizohen të dhëna:

- Analizë kualitative e dokumenteve(AKD): hulumtime dhe analizë e organizatave të tjera hulumtuese dhe institucioneve akademike, organizata joqeveritare, hulumtues individual dhe ngjashëm. Dokumente zyrtare të publikuara nga institucione publike (akte juridike, akte nënligjore, strategji, raporte vjetore, procesverbale nga mbledhjet, kumtesa për mediat) dhe tekste mediatike (lajme, raporte, analiza dhe materiale të tjera të publikuara).
- Intervista kualitative me 11 persona (gazetarë, avokatë, ekspertë mediatik, përfaqësues të institucioneve publike ose organizatave joqeveritare)
- Anketë me 69 gazetarë nga shtëpi të ndryshme mediatike, e zhvilluar gjatë vitit 2016, në bazë të një pyetësori të strukturuar i cili është përgatitur në kuadër të hulumtimit ndërkombëtar të Botërave të Gazetarisë (Worlds of Journalism Study)
- Të dhëna zyrtare statistikore të cilat janë kërkuar nga institucionet publike ose janë marrë nëpërmjet ueb faqeve të internetit, ose janë publikuar nga ndonjë burim tjetër.

Hulumtimi tregon se gjendja e lirisë së shprehjes në Maqedoni është përkeqësuar dhe është thajse e njëjtë me vitin e kaluar. Ky përfundim nuk ndryshoi edhe përkundër faktit që në mesin e këtij viti, Maqedonia u bë me një Qeveri të re e cila çështjet e lirisë së mediave dhe sigurisë së gazetarëve, i vendosi në listën e prioriteve.

Siç është theksuar në raportin vjetor të Freedom House për vitin 2017<sup>1</sup>, mediat në Maqedoni nuk janë të lira. Ndërsa sipas indeksit të lirisë së mediave të Reporterëve Pa Kufinj, Maqedonia gjendet në vendin e 111 nga gjithësej 180 shtete.

## **Indikatori A: Siguria juridike e lirisë së mediave**

Liria e mediave është e mbrojtur me Kushtetutë<sup>2</sup>, por ligjet për mediat ende janë problematike pasi që nuk janë në harmoni me rekomandimet e Këshillit të Evropës dhe praktikën e Gjykatës Evropiane për të drejtat e njeriut në Strazbur.

Gjatë vitit 2017 nuk kishte intervenime në kornizën ligjore e as ndryshime më të mëdha të rregullativës ligjore, respektivisht Ligjit për Media dhe Ligjit për Shërbime Audio dhe Audiovizuale<sup>3</sup>.

Në kuadër të bisedimeve politike mes partive për zgjidhjen e krizës politike, e cila ishte me ndërmjetësim të faktorit ndërkombëtar, u ndryshua neni 75 i Kodit Zgjedhor, dhe shkaku i këtij ndryshimi duhej bërë edhe harmonizimi me Ligjin e Mediave. Këto ndryshime kishin për qëllim që nëpërmjet intervenimit direkt politik në ligjet, të përmirësohet raportimi gjatë periudhës së fushatës zgjedhore. Mediat private dhe servisi public u obliguan me ligj që gjatë fushatës zgjedhore të raportojnë në mënyrë të drejtë, të balancuar dhe të paanshëm. Kjo qasje ishte kritikuar nga SHGM-ja pasi partitë në vend se merren me shkaqet të cilat kanë sjellë jë situatë të raportimit joprofesional të mediave, merren me pasojat.

Me këto ndryshime ligjore, partite u dakorduan që të formohet një Komision Ad Hok, në kuadër të Agjencisë së Mediave, e cila do të monitorojë raportimin e mediave gjatë fushatës zgjedhore. Ky trup Ad Hok me pesë anëtarë, të gjithë të nominuar nga katër partitë në bisedime, bëri vlerësimin e raportimit të mediave gjatë fushatës, ndërsa Agjencia e Mediave, në bazë të këtij monitorimi, përpilonte raporte dhjetë ditore në të cilat konstatohej cënimi i principeve të raportimit të drejtë për kandidatët. Poashtu i propozohej gjykatës masa që duhet marrë ndaj mediumit që ka bërë shkeljen.

Gjatë periudhës zgjedhore, trupi ad hok ka ngritur afro gjashtëdhjetë(60) procedura kundër mediave, prej të cilave gjashtëmbëdhjetë(16) kishin të bëjnë me raportim të pabalancuar, gjashtë (6) për reklamim të fshehur të funksionarëve dhe njëzetë (20) për reklamim politik.

Deri në ditën e zgjedhjeve, gjykatat shqyrtuan vetëm dy lëndë, dhe që të dyjat i refuzuan. E kjo gjë e vërtetoi qëndrimin e SHGM-së dhe organizatave lokale mediatike, si dhe qëndrimin e opinionit ekspert se problemet e sektorit mediatik, nuk mund të menaxhohen me zgjidhje të përkohshme, por me reforma të qëndrueshme dhe serioze.

1 Freedom House - Liria e Mediave, Lëshuar më 29 nëntor, 2017: <https://freedomhouse.org/report/freedom-press/2017/macedonia>

2 Kushtetuta e Republikës së Maqedonisë

3 Ligji për Media në Republikën e Maqedonisë.



Gjithashtu, në korrik të vitit 2016, katër partitë më të mëdha parlamentare, nga pushteti dhe opozita, u morën vesh që opozita të propozojë kryeredaktor të programit informativ të Radio Televizionit Publik, RTVM1, në konsultim edhe me partitë e tjera parlamentare. Kjo do ndodhte njëqind (100) ditë para zgjedhjeve, ndërsa natën e zgjedhjeve kryetarit do ti skadojë mandati.

#### **Indikatori B: Pozita e gazetarëve në redaksi, etika profesionale dhe niveli i censurës.**

Sa i përket pozitës së gazetarëve në redaksi, etikën profesionale dhe nivelin e censurës, mund të konstatohet se gjendja është përkeqësuar. Tre gazetaret më të mëdha ditore u mbyllën, ndërsa mbi 100 gazetar mbetën pa punë. Por rrezik nuk ka vetëm tek mediat e shkruara. Politika e gabuar e Qeverisë së kaluar, përdorimi i parave publike për financimin e mediave private, me qëllim që të kontrollohet politika e tyre redaktuese, solli një lëvizje të rrënjësishme në sektorin mediatik dhe i futi mediat në rreziqe të padëshirueshme.

Në kushte kur tregu mediatik është i stërmbytur me media, dhe media të dobëta, e kur Qeveria është reklamuesi më i madh, shumica e mediave mbijetesën e kanë vetëm nëse vendosin raporte klienteliste me Qeverinë.

Mediat e tilla anojnë kah Qeveria, dhe kanë nivel të lartë të vetëcensurimit. Rreziku i pushimit të gazetarëve nga puna është shumë i lartë. Shpesh gazetarët e përjashtuar fillojnë të punojnë në media online, të cilat kanë një numër shumë më të vogël të të punësuarve. E kjo ndikon në kualitetin e përmbajtjeve të publikuara, dhe shpesh shkelen standardet etike dhe profesionale.

#### **Indikatori C: Siguria e Gazetarëve**

Në Republikën e Maqedoni siguria e gazetarëve është e cenuar. Ata ende sulmohen për shkak të punës së tyre. Gjatë kësaj periudhe janë regjistruar madje 18 raste të sulmit ndaj gazetarëve, prej të cilave shumica janë sulme fizike dhe verbale. Krahasuar me vitin e kaluar, dallimi është në atë se Qeveria e re dhe policia, në mënyrë deklarative kanë shprehur gatishmëri për të bashkëpunuar me Shoqatën e Gazetarëve. E gjithë kjo me qëllim që ti vihet fund politikës së mosndëshkimit të dhunës ndaj gazetarëve.

Por, deri në arritjen e cakut përfundimtar – ndërtim i një mekanizmi institucional për parandalim dhe ndëshkim të dhunës ndaj gazetarëve – jemi shumë larg.

SHGM prej janarit të këtij viti e ka përmirësuar bashkëpunimin me MPB-në, ndërsa pritet edhe përmirësimi i bashkëpunimit me prokurorinë.



A

## Mbrojtja Juridike e Lirisë së Mediave

## **A.1.A siguron legjislativi vendor garanca për lirinë e mediave dhe të njëjtat a zbatohen në mënyrë efikase në praktikë?**

Gjatë vitit 2017 nuk kishte intervenime në kornizën ligjore, e as nuk kishte ndryshime më të mëdha në rregullativën ligjore. Prandaj, të gjitha konstatimet lidhur me garancat juridike që ishin theksuar në raportin e vjetshëm janë valide<sup>4</sup>. Megjithatë, në krahasim me vitin e kaluar, dukshëm ka ndryshime në kontekst politik dhe kjo është shkak që një pjesë e vlerësimeve në këtë raport dallohen në sasi të konsiderueshme nga ato të vitit të kaluar.

Korrniza bazë ligjore për mediat në Maqedoni përbëhet prej: Ligjit për media<sup>5</sup> dhe Ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe AudioVizuele<sup>6</sup>.

Në periudhën që përfshihet në këtë raport, nuk kishte thuajse asnjë ndryshim në kornizën ligjore e cila ka të bëjë me mediat. Nga ana tjetër, liria e mediave ishte një prej temave kryesore rreth të cilave zhvillohej debati politik dhe debati i ekspertëve.

Periudha nga raporti i fundit, deri në shtator të vitit 2017 ishte shënuar tërësisht me zgjedhjet e dhjetorit të vitit 2016, të cilat duhej ta nxjerrin vendin nga kriza e thellë politike dhe institucionale.

Kah fundit i vitit 2017, u krijua Qeveria koalicionuese e kryesuar nga opozita e deriatëherëshme (LSDM) dhe disa parti që përfaqësojnë etnitetin shqiptar në Maqedoni, (BDI dhe Aleanca për Shqiptarët). Partia që deri atëherë qeveriste me shtetin, VMRO DPMNE, që ishte në pushtet nga viti 2006 e këndej, tashmë kaloi në taborin opozitar.

Si rezultat i zhvillimeve të tilla të ngjarjeve në skenën politike, Kuvendi i Maqedonisë nuk funksiononte thuajse nëntë (9) muaj. Në të njëjtën periudhë, Maqedonia kishte një Qeveri teknike e cila në pajtueshmëri me Marrëveshjen e Përzhinos, do udhëhiqte shtetin nga fillimi i vitit 2016 e deri në mesin e vitit 2017, pa një mandat të qartë politik dhe me kompetenca të kufizuara.

Për shkak të kësaj situate, pushteti ligjvënës gjatë kësaj periudhë për kur është shkruar raporti, ka patur një numër të vogël aktivitete.

Si reagim ndaj krizës politike, por edhe ndaj presionit të faktorit ndërkombëtar, për shkak të situatës së vazhdueshme të demokracisë së cunguar dhe lirisë së

mediave<sup>7</sup> – por edhe si rezultat i Marrëveshjes së Përzhinos<sup>8</sup> gjatë mbrëmjes së zgjedhjeve u bë një intervenim në nenin 75 të Kodit Penal, dhe u bë intervenimi adekuat në Ligjin për Media, i cili kishte për qëllim ta largojë ndikimin e Qeverisë tek mediat.

Me këto intervenime<sup>9</sup> servisi publik, mediat private, mediat elektronike (publikimet) (portalet e internetit) u obliguan që t'i mbulojnë zgjedhjet në mënyrë të drejtë, të balancuar dhe të paanshme, për gjatë gjithë programit të tyre.

Sipas vlerësimit të OSBE-ODIHR<sup>10</sup>-së i cili ka ndjekur zgjedhjet parlamentare të vitit 2016, dhe me të cilin SHGM-ja pajtohet plotësisht, reformat e parapara mediatike të shkruara në Marrëveshjen e Përzhinos, nuk janë përfunduar dhe zbatuar në periudhën parazgjedhore.

Në periudhën mes gushtit të vitit 2016 dhe shtatorit të vitit 2017, për çka është ky raport që po shkruajmë, nuk është vërejtur tentativë e qeverisë së re për të vazhduar me kufizimin e hapësirës së internetit ose online mediave, edhe pse kërkesat e tilla për “rregullim” gjoja të gjendjes në sektorin online patën buruar pikërisht prej njerëzve të afërt me pushtetin e ri<sup>11</sup>.

Në planin 3-6-9 të kësaj qeverie, është paraparë që të ketë debat për nevojën e ndryshimit dhe plotësimit të Ligjit të Mediave që në fakt mund të nënkuptojë edhe debat për nevojën e një rregullative ligjore edhe për mediat online.

Por tek duhet të qartësohen dilemat nëse kërkesat për rregullativë më të rreptë ligjore të mediave online janë rezultat i vërtetë një shqetësimi të argumentuar, ose janë vetëm diçka e qëllimshme për ta kufizuar lirinë e shprehjes në internet, gjë që është në kundërshtim me zotimet e Këshillit të Evropës dhe organizatave të tjera ndërkombëtare të cilat e përfaqësojnë lirinë në internet<sup>12</sup>.

4 SHGM, Indikatorë për nivelin e lirisë së mediave dhe sigurinë e gazetarëve të Maqedonisë, viti 2016, faqe 10.  
5 Ligji i Mediave të Republikës së Maqedonisë.  
6 Ligji për Shërbime Audio dhe Audio Vizuele.

7 Në raportin e grupit senior të BE-së, ekspertë të kryesuar nga Pribe, në vitin 2015, thuhet se mediat janë të ndikuara fortë nga politika dhe partitë politike, sidomos nga Qeveria e atëherëshme. Shiko: [https://ec.europa.eu/neighborhood-enlargement/sites/near/files/news\\_corner/news/news-files/20150619\\_recommendations\\_of\\_the\\_senior\\_experts\\_group.pdf](https://ec.europa.eu/neighborhood-enlargement/sites/near/files/news_corner/news/news-files/20150619_recommendations_of_the_senior_experts_group.pdf).  
8 Marrëveshja e Përzhinos. Qasur më 21 nëntor, 2017: <https://www.mkd.mk/makedonija/politika/dui-go-objavi-celosniot-dogovor-na-liderite-od-2-juni>.  
9 Kodi Penal i Republikës së Maqedonisë, neni 75.  
10 OSBE, Ish Republika Jugosllave Republika e Maqedonisë- Zgjedhje të parakohshme parlamentare më 11 dhjetor 2016 - misioni mbikqyrës për zgjedhje OSBE-ODIHR (Varshavë: 2017) Qasur më 29 nëntor, 2017: <http://www.osce.org/mk/odihr/elections/fyrom/302261?download=true>.  
11 Viktor Dano, “Po thyhen shigjeta për rregullimin e mediave online dhe blogerëve” IT.mk, 21 janar 2016. Qasur më 30 nëntor, 2017: <https://www.it.mk/se-krshat-kopja-za-regulirane-na-onlajn-mediumite-i-blogerite/>.  
12 Snezhana Trpevska, intervistë me anëtar të ekipit të SHGM-së, korrik 2017.

Katër partitë politike, pjesëmarrëse në bisedimet e Përzihos, patën dakorduar ndryshime në legjislativin mediatik, në gjashtë muajt e parë nga formimi i Qeverisë së re, në pajtueshmëri me rekomandimet e Pribe-së<sup>13</sup>.

Këto ndryshime duhej të bënin reformat rrënjësore në sektorin mediatik, me qëllim që mediat të lirohen nga ndikimet politike, ekonomike dhe të tjera. Në momentin kur po e përgatitej ky raport, afati gjashtë mujor ende nuk kishte kaluar, por në planin e quajtur 3-6-9<sup>14</sup> të Qeverisë, të publikuar më 17 korrik 2017, janë paraparë edhe masa që kanë të bëjnë me gjendjen e mediave.

Miratimi i një deklarate për shprehjen e një synimi të fortë politikë, si dhe dhe mbështetje nga Qeveria dhe institucionet për zbatimin e vazhdueshëm të Kodit Etik për raportim të mediave.

- Sjellja e vendimit të Qeverisë për të ndaluar reklamën qeveritare tek radiodifuzerët privat ose komercijal (me përjashtim të mediave sociale) dhe transmetimi i komunikimi me qytetar nëpërmjet servisit publik radiodifuziv.
- Publikimi i të gjithë harxhimeve për reklamim të Qeverisë dhe shpjegim të kriterëve për përzgjedhjen e mediave për periudhën prej vitit 2008 deri në vitin 2017, në formatin e dorëzuar nga Komisioni Evropian.
- Zhvillimi i një konsultimi publik me mediat, shoqatat mediatike dhe organizatat joqeveritare.
- Përgatitja e propozim ndryshimeve në Ligjin për Media dhe në Ligjin për Shërbime Audio dhe Audiovizuale, që do të mundësojnë zbatimin e Kodit Etik gjatë raportimit në periudhë zgjedhore dhe jashtë saj, si dhe për përforcimin e pavarësisë dhe kapacitetit të rregullatorit mediatik dhe servisit publik.
- Përgatitja e propozim ndryshimeve të rregullativës ligjore me të cilën do të mundësohet emërimi i anëtarëve të Këshillit të Agjencisë së Mediave sipas meritave.
- Përgatitja e shqyrtimit të të gjithë rasteve të deritanishme të sulmeve fizike dhe verbale ndaj gazetarëve, presioneve, fjalorit të urrejtjes dhe ngjashëm.
- Organizimi i brifingut të Qeverisë me gazetarë, një herë në javë.

Plani 3-6-9 ende nuk është shndërruar në zgjidhje konkrete, edhe pse janë marrë disa hapa fillestar. Më 22 gusht të vitit 2017, Qeveria miratoi një konkluzë me të cilën ndalohen të gjitha reklamën e Qeverisë tek radiodifuzerët komercial dhe tek mediat e shkruara, ose gazetatat.

Kjo ndalesë për reklamim tek mediat private u përhëndet nga SHGMja dhe organizatave të tjera joqeveritare që kanë të bëjnë me mediat, pasi me vite kishin paralajmëruar se pjesëmarrja tejet e madhe e Qeverisë në financimin e mediave private, i bën mediat të varura financiarisht nga Qeveria dhe e cenon lirinë redaktuese.

Por, ende një zgjidhje e tillë nuk mjafton, pasi neni 102 nga Ligji për Shërbime Audio dhe Audiovizuale ende i jep mundësi Qeverisë që të reklamohet dhe nëpërmjet kësaj, mund të ndikojë në tregun mediatik. Prandaj më së miri është ky nën të shfuqizohet tërësisht.

Qeveria e re publikoi të dhëna se Qeveria e kaluar, gjatë periudhës prej vitit 2008 e deri në vitin 2015, ka harxhuar 38 milion euro për fushatë mediatike<sup>15</sup> dhe për analizimin e mendimit publik<sup>16</sup>, që është vërtetim i konkluzës nga analiza e vitit të kaluar, edhe atë se Qeveria ka përdorur në mënyrë të vazhdueshme mjetet publike, për të korruptuar media nëpërmjet gjoja fushatave qeveritare<sup>17</sup>. Për nevojat e këtij raporti, në bazë të normave nga Ligji për qasje deri tek informatat me karakter publik, SHGM kërkoi të dhëna nga ministrinë dhe komunat, shumën e parave të harxhuara për reklamim gjatë vitit të kaluar. Kërkesa u është dërguar gjithë ministrive, edhe deri tek ata komuna që vitin e kaluar nuk na dhanë përgjigje ose nuk kishin harxhuar para për reklamim. Vetëm një ministri nuk dha përgjigje, ndërsa më pak se një e treta e komunave poashtu nuk janë përgjigjur.

Për dallim prej vitit të kaluar, harxhimi total i ministrive për këtë vit, është shumë më i ulët. Komunat të cilat nuk dhanë përgjigje ose gjatë vitit të kaluar nuk kishin patur harxhime të tilla, nuk dallonin nga mesatarja e vjetshme, përveç komunës së Prilepit e cila në gjashtë muajt e parë ka harxhuar 2.168.252,00 denarë (sipas vlerësimit të tyre në vitin 2017 do harxhohen 4.000.000,00 denarë), ndërsa kjo është njësoj sikurse harxhimi i Ministrisë së Punëve të Brendshme e cila vitin e kaluar u dallua si reklamuesja më e madhe.

Lidhur me pavarësinë e rregullatorit dhe servisit publik, me përjashtim të ndryshimeve të dakorduara nën ligjore në Marrëveshjen e Përzihos, nuk janë sjellë akte të reja ligjore dhe nënligjore, që para së gjithash ishte rezultat i krizës politike me të cilët ballafaqohej Maqedonia gjatë periudhës së kaluar.

Prandaj, edhe në këtë raport sikurse në atë të vitit të kaluar, kualifikimet për pavarësinë e këtyre dy institucioneve kryesisht mbesin të njëjta.

<sup>13</sup> "(INTEGRALE) i gjithë raporti i Rajhard Pribe-së për krimin, korrupsionin dhe përgjimin", Loakel, 19 qershor 2015, qasur më 27 nëntor 2017, <http://lokalno.mk/integralno-celiot-izveshtaj-na-rajhard-pribe-za-kriminalot-korupcijata-i-prislushuvanjeto-na-vlasta/>

<sup>14</sup> Qeveria e Republikës së Maqedonisë, Plani 3-6-9 qasur më 21 nëntor, 2017: <http://www.sep.gov.mk/data/file/Dokumenti/Plan%203-6-9%20MK.pdf>.

<sup>15</sup> Në këtë shumë nuk janë llogaritur viti 2006, 2007 dhe 2016 pasi dokumentet e këtyre viteve nuk janë gjetur.

<sup>16</sup> Qeveria e Maqedonisë. Qeveria e mëparshme ka harxhuar 38 milion euro për fushatë mediatike për hulumtimin e mendimit publik. Qasur më 21 nëntor. 2017: <http://mada.mk/node/13464>.

<sup>17</sup> Për krahasim shiko faqen 17 të raportit të vjetshëm. I kapshëm në: [http://znm.org.mk/?page\\_id=1357](http://znm.org.mk/?page_id=1357).

Është me rëndësi që të theksohet se gjatë periudhës së kaluar, kishte një përmirësim të vogël në punën e rregullatorit mediatic, ndërsa më pak në servisin publik. Në kuadër të kësaj janë edhe vlerësimet e disa prej gazetarëve të intervistuar:

*“2017-ta konkretisht ndoshta ka përmirësim për një nivel minimal, me ardhjen e Qeverisë së re. Kjo pasi pasi që ka mbaruar tallja dhe fyerja në internet dhe në media. Mirëpo situata e përgjithshme ende është shumë dëshpruese, por me pak shpresë për normalizimin dhe vënien në funksion të gazetarisë profesionale<sup>18</sup>”.*

Lidhur me rregullatorin, shumica e gazetarëve dhe ekspertëve të intervistuar vërtetuan se ekziston një tendencë për përmirësimin e profesionalitetit dhe objektivitetit gjatë vitit të fundit, por kjo ende nuk do të thotë se rregullatori mediatic është plotësisht i pavarur.

*“Agjencia e Mediave asnjëherë nuk ka qenë e pavarur nga partitë në pushtet. Mjafton që shikohet ekipi i anëtarëve të Këshillit të Agjencisë dhe mund të vihet në përfundim sikurse shumica e gazetarëve dhe aktivistëve të pavarur, se Agjencia e Mediave është e politizuar. Përmirësimi i punës së rregullatorit është vërejtur në vendimet e shumta dhe masat e shqiptuara të këtij trupi që ishin principele dhe të sjella nga një pozitë e pavarur<sup>19</sup>”.*

Përfaqësuesi i SHGM-së në rregullatorin mediatic vlerëson se në mënyrë që fshihet fotografia e tillë (tërësisht), është e nevojshme një periudhë më e gjatë kohore e punës profesionale të Agjencisë, e cila është e obliguar që të mbajë llogari për ambientin e përgjithshëm në të cilin punojnë mediat<sup>20</sup>.

Ekziston një perceptim i përgjithshëm se problemi është i natyrës sistematike, prandaj fillimisht duhet të krijohet një ambient më i përshtatshëm ligjor, në mënyrë që pastaj të krijohet pavarësi e plotë dhe profesionalizim i trupit rregullator të Maqedonisë

Perceptim të ngjashëm lidhur me punën e Agjencisë ka edhe sa i përket gjuhës së urrejtjes, edhe pse në disa raste të caktuara gjatë vitit 2016 dhe 2017, Agjencia konstatoi gjuhë të urrejtjes pasi disa vitesh pasivitet të plotë. Për shembull, lidhur me masat e shqiptuara për shkak të gjuhës së urrejtjes së konstatuar në një

emision në televizionin Sitel<sup>21</sup>, si pjesë e raportimit zgjedhor në dhjetor të vitit 2016, përshtypja e një pjese të gazetarëve të intervistuar është se “Agjencia edhe në këto zgjedhje, sikurse në zgjedhjet e kaluara nuk ishte mjaftueshëm e fuqishme që ti heshtë gazetarët dhe mediat që shpërndanin gjuhë të urrejtjes<sup>22</sup>. Këtë mendim e ndajnë edhe punonjësit mediatic të intervistuar për nevojat e këtij raporti.

*“Gjuha e urrejtjes, retorika e diskriminimit ndaj grupeve dhe individëve të caktuar, kërcënimet publike dhe thirrjet publike për dhunë, janë praktikë në një pjesë të mediave kombëtare, elektronike dhe të shkruara, që fatkeqësisht gjatë viteve të fundit ka eskaluar<sup>23</sup>”.*

Për momentin nuk ka asnjë rast të gjuhës së urrejtjes tek Gjykata Penale e as nuk ka informatë nëse Prokuroria ka marrë ndonjë masë tjetër për këtë çështje: Problemi i gjuhës së urrejtjes është sistematik dhe institucionet kompetente ende e tolerojnë këtë sjellje në media:

Lidhur me gjendjen në servisin publik konkluzat e cila buron nga intervistat e shumta është se servisi ende nuk ka një autonomi institucionale e aq më pak politike të pavarur redaktuese<sup>24</sup>.

Në mënyrë që të ketë përmirësim, gjatë emërimit të redaktorëve dhe drejtorëve, përveç Kuvendit<sup>25</sup>, duhet të ketë pjesëmarrje edhe opinioni dhe gazetarët.

Poshtu, ekziston një nivel i lartë i pajtueshmërisë me organizatave të gazetarëve dhe opinionit të ekspertëve lidhur me financimin e qëndrueshëm të RTVM-së, pavarësinë e Këshillit Programues të RTVM-së, prodhimin e programit kualitativ mediatic, zgjedhjen e ekipit profesional të redaktorëve, punësimin e gazetarëve kualitativ dhe kreativ, zhvillimi e rrjetit të korrespondentëve e të tjerë.

18 Darko Çekirovski, intervistë me anëtar të ekipit të SHGM-së korrik, 2107.

19 Snezhana Trpevska, intervistë me anëtar të ekipit të SHGM-së korrik, 2017.

20 Zoran Fidanovski, intervistë me anëtar të ekipit të SHGM-së korrik, 2017.

21 Agjencia e medive ka konstatuar gjuhë të urrejtjes në Sitel. Ako.mk, për herë të fundit e ndryshuar më 21 nëntor, 2017:

<http://ako.mk/%D0%B0%D0%B3%D0%B5%D0%BD%D1%86%D0%B8%D1%98%D0%B0-%D0%B7%D0%B0-%D0%BC%D0%B5%D0%B4%D0%B8%D1%83%D0%BC%D0%B8-%D0%BA%D0%BE%D0%BD%D1%81%D1%82%D0%B0%D1%82%D0%B8%D1%80%D0%B0%D1%88%D0%B5-%D0%B3%D0%BE%D0%B2/>.

22 Gazetar i cili dëshiron të mbetet anonim, intervistë me anëtar të ekipit të SHGM-së korrik, 2017.

23 Miladen Čadikovski, intervistë me anëtar të ekipit të SHGM-së korrik, 2017.

24 Zoran Fidanovski, intervistë me anëtar të ekipit të SHGM-së korrik, 2017.

25 Ivan Bojaxhiski, intervistë me anëtar të ekipit të SHGM-së korrik, 2017.

## **A.2. A shkaktojnë efekt frike tek gazetarët Ligjet për shpifje?**

Shpifja dhe fyerja u dekriminalizuan në vitin 2012 me sjelljen e Ligjit për përgjegjësi civile për shpifje dhe fyerje<sup>26</sup>. Gjatë vitit të kaluar, nuk janë bërë ndryshime të këtij ligji. Siç ishte theksuar në raportin e kaluar, gjatë periudhës së vitit 2013 e deri në vitin 2015, janë konstatuar një numër i madh i kontesteve ku paditësit më së shpeshti ishin funksionarë të lartë shtetëror, ndërsa të paditurit ishin gazetarë të cilët raportojnë në mënyrë kritike për punën e pushtetit.

Thuajse të gjithë rastet mbaruan me epilog pozitiv për paditësin, dhe u shqiptuan gjykatat të larta në para për të paditurit. Gjatë vitit 2013 dhe 2014, kishte dhjetëra procedura civile për shpifje dhe fyerje, edhe pse shumica e tyre ishin zgjidhur me ndërmjetësim, jashtë procedurës gjyqësore.

Në raportin e parë i cili është për periudhën prej qershorit të vitit 2016, janë vërejtur afro 40 padi për shpifje dhe fyerje kundër gazetarëve. Para dekriminalizimit, numri i tyre ishte diku afro 330.

Në periudhën e cila është përfshirë në raport, sipas informatave të siguruar nga avokati i SHGM-së i cili i përfaqëson anëtarët e Shoqatës, në raste të ofendimit dhe shpifjes, ka rreth 30 lëndë aktive, që nënkupton se ka një trend të dukshëm të zvogëlimit të numrit të lëndëve ose padive për ofendim dhe shpifje, që gjatë periudhës së kaluar, shfrytëzohej si mekanizëm për presion ndaj gazetarëve.

Nuk ekziston një evidencë precize se sa përqind e këtyre rasteve janë të nisura nga administratorë shtetëror ose politikanë, por përshtypja e përgjithshme nga intervistat e realizuara dhe nga monitorimi i praktikës gjyqësore, është se shpifja dhe ofendimi gjatë vitit të fundit shfrytëzohen më pak nga pushteti për presion ndaj gazetarëve kritike.

Përrjashtim janë dhjetëra padi për shpifje të funksionarëve të lartë të partisë qeverisëse BDI që janë ngritur kundër mediave kritike në gjuhën shqipe.

Në Raportin mbi gjendjen e të drejtave të njeriut në Maqedoni për vitin 2017, të publikuar nga Stejt Departamenti Amerikan, kjo dukuri është kualifikuar si një mjet për censurim të gazetarëve kritik.

Të njëjtin perceptim e ndajnë gjithë gazetarët e intervistuar për nevojat e këtij raporti. Gazetari Mladen Čadikovski vlerëson se gjendja është përmirësuar në mënyrë të konsiderueshme, por ende ka lëndë të shpifjes dhe ofendimit kundër gazetarëve që po zhvillohen nëpër gjykata. Një prej gazetarëve të intervistuar i cili zgjodhi që të mbetet anonim, vlerëson se arsyeja e zvogëlimit të numrit të proceseve të tilla gjyqësore “nuk ka të bëjë me zgjimin e funksionarëve qeveritar, por ka të bëjë me krizën politike e cila filloi me publikimin e bisedave të përgjuara nga opozita, dhe kjo ua shpërqëndroi vëmendjen më shumë kah puna e Prokurorisë Speciale dhe zgjedhjet e parakohshme parlamentare”

---

26 Gazeta zyrtare e RM-së, 143/2012

### A.3. A ekziston mbrojtje e mjaftueshme e pluralizmit politik në media, para dhe gjatë fushatë zgjedhore?

Siç ishte theksuar në raportin e vitit të kaluar, në ciklet e mëparshme zgjedhore, deri në vitin 2016, mediat më me ndikim, që ishin të afërta me pushtetin, aspak nuk i respektonin rregullat për pluralizëm politik gjatë raportimit. Prandaj në qershor të vitit 2016, katër partitë më të mëdha parlamentare u pajtuan që të zbatohen masa të përkohshme të cilat do të vlejnin për fushatën e zgjedhjeve të parakohshme.

Këto masa përfshinin edhe emërimin e kryeredaktorit të lajmeve të RTVM1 nga opozita, në konsultim dhe partitë e tjera parlamentare, dhe mandati i tij do të zgjaste 100 ditë para zgjedhjeve, dhe do të mbaronte natën e zgjedhjeve, si dhe u dakordua formimi i një komisioni të përkohshëm për mbikqyrje të raportimit të mediave audiovizuale gjatë fushatës parazgjedhore, e ashtuquajtur trupi AD HOK, e cila funksiononte në kuadër të Agjencisë për Shërbime Audio dhe Audiovizuale.

Arsye për formimin e këtij komisioni në kuadër të Agjencisë, e cila në fakt, e ka atë kompetencë të monitorimit, është se dominonte perceptimi se gjatë viteve të kaluara, Agjencia nuk e ka kryer punën ose funksionin në mënyrë të pavarur dhe të paanshme.

SHGM, organizata lokale mediatike dhe ekspertët e tjerë, e kritikonin këtë koncept si zgjidhje pasi shfuqizon ose zëvendëson kompetencat themelore të Agjencisë, por edhe standardet profesionale të gazetarisë, që gazetarët të mbajnë distancë nga cilado parti politike. Kjo për faktin se partitë politike kanë propozuar individë për pozitën e redaktorit në servis publik dhe anëtarë të komisionit AD HOK.

Më 31 gusht të vitit 2016, kur u vu në funksion kryeredaktori i ri i RTVM-së<sup>27</sup>, me propozim të opozitës së atëhershme, u krijua edhe Komisioni AD HOK i cili kishte për obligim që të monitorojë zbatimin e normave nga Kodi Zgjedhor, për mbulimin e fushatës zgjedhore nga ana e mediave audiovizuale<sup>28</sup>.

Komisioni AD HOK funksionoi deri në fund të fushatës zgjedhore, ndërsa ishte e përbërë prej pesë anëtarëve (më së paku), njëri duhej të jetë shqiptar. Nga dy anëtarë ishin propozuar prej partisë në pushtet ndërsa dy prej opozitës, ndërsa anëtar i pestë u zgjodh me konsensus mes anëtarëve të zgjedhur.

Njëqind ditë para zgjedhjeve, Agjencia për Shërbime Audio dhe Audio Vizuale kishte për obligim që të krijojë procedura për monitorimin e raportimit të balancuar,

ashtu siç është paraparë në Kodin Zgjedhor. Trupi AD HOK ka vlerësuar raportimin e mediave audiovizuale për aktorët politikë dhe kandidatë, bazuar në raportet e monitorimit që i përpilonte ekipi profesional i Agjencisë së Mediave çdo dhjetë ditë.

Trupi AD HOK duhej ta merr përgjegjësinë e mbikqyrësit të rolit të Agjencisë së Mediave, por plotësimet që u bënë në Kodin Zgjedhor, nuk ishin tërësisht të harmonizuara dhe të qarta, gjë që shkaktoi paqartësi për mandatin e komisionit para nisjes së fushatës - prej 17 tetorit, kur ishin përcaktuar të mbaheshin zgjedhjet, deri më 21 nëntor, kur zyrtarisht nisi fushata zgjedhore.

Me ndryshimet në Kodin Zgjedhor, ishte paraparë që Agjencia për Shërbime Audio dhe Audiovizuale, të bëjë monitorimin e mediave online. Por edhe përkundër obligimit ligjor, Agjencia e Mediave nuk e monitoroi punën e mediave online, ose portaleve, pasi që nuk ekziston një regjistër i mediave online, dhe nuk ka një praktikë të tillë rregullatore në Evropë.

Komisioni propozoi afro gjashtëdhjetë (60) procedura kundërvajtëse, prej të cilave, gjashtëmbëdhjetë(16) për raportim të pabalancuar, gjashtë(6) për reklamim të fshehur të funksionarëve qeveritar, dhe njëzet(20) për reklamim politik. Deri në ditën e zgjedhjeve, gjykatat kanë shqyrtuar vetëm dy lëndë, dhe që të dyja u refuzuan.

Vlerësimi kryesor i misionit ndërkombëtar mbikqyrës, ishte se zotimet e partive lidhur me mediat, nuk ishin zbatuar në praktikë – konstatim me të cilin SHGM dhe organizatat e tjera mediatike dhe vëzhguese u pajtuan<sup>29</sup>.

Perceptimi i përgjithshëm i gazetarëve të intervistuar është se “Komisioni Ad Hok ishte një trup i imponuar, i krijuar me një marrëveshje politike<sup>30</sup>”. Ky trup gjatë punës shfaqti shumë ndarje politike, që ishte tregues për afërsinë e anëtarëve me partitë politike të cilat i kanë nominuar për atë detyrë. Kishte edhe tentime për balancim gjatë vendimmarjes, por megjithatë ky trup nuk arriti të imponohet si faktor serioz i cili ka besueshmëri tek mediat.

Lidhur me rezultatin respektivisht efektivitetin e këtij trupi, ekziston mendimi se formimi i tij është një precedent i cili nuk guxon të përsëritet pasi që ishte krijuar nga anëtarë të nominuar nga parti politike. Me këtë trup faktikisht hijezohej kompetenca e Agjencisë së Mediave, si pasojë e asaj që kjo Agjenci nuk e kishte kryer punën e saj në mënyrë të paanshme dhe të pavarur<sup>31</sup>.

27 “Santa Argirova, kryeredaktore e re e programit informativ të RTVM-së, 31 gusht 2016, qasur më 27 nëntor 2017: <http://fokus.mk/santa-argirova-nov-urednik-na-informativnata-programa-na-mtv/>.

28 “Përbërja e Komisionit Ad Hok tashmë është e njohur”, Fokus, 9 gusht, qasur më 27 nëntor, 2017: <http://vecer.mk/makedonija/poznat-sostavot-na-ad-hok-teloto>.

29 SHGM përhëndeti konkluzat e monitoruesve ndërkombëtar të mediave”, MKD.MK, 13 dhjetor 2016, qasur më 27 nëntor, 2017: <https://www.mkd.mk/makedonija/politika/znm-gjipozdravi-naodite-na-megjunarodnite-nabljuduvachiza-mediumite>.

30 Gazetar i cili dëshiron të jetë anonim, intervistë me anëtar të ekipit të SHGM-së korrik, 2017.

31 Snezhana Trpevska, intervistë me anëtar të ekipit të SHGM-së korrik, 2017.



#### A.4. A garantohet me ligj liria e punës së gazetarisë dhe shoqatës dhe a zbatohet ligji i tillë?

Ligjet formalisht e garantojnë lirinë e punës gazetareske dhe shoqatës, por në praktikë kjo nuk është ashtu. Në Maqedoni, profesioni i gazetarisë nuk është i licencuar, po nga ana tjetër është e definuar në Ligjin për Media<sup>32</sup>. Më konkretisht, gazetari definohet si “person i cili mbledh, analizon, përpunon ose klasifikon informata të publikuara në media, dhe është i punësuar në media, si dhe ka kontratë për punë me ta, ose është person i cili realizon aktivitetet gazetareske si profesion i pavarur (gazetar i lirë, freelancer)

SHGM me organizatat e tjera mediatike ishin dhe ende janë kundër definimit të profesionit gazetaresk me ligj. Sipas tyre, definimi i gazetarisë si një profesion i lirë, krijon bazament për kufizimin e punës së gazetarit. Prandaj gazetarët ose profesioni i vërtetë i gazetarisë mund të jetë vetëm lëndë e vetërregullimit e jo edhe e rregullimit ligjor. Prandaj, zotimi i SHGM-së është që ky nen i Ligjit për Media të fshihet tërësisht<sup>33</sup> - qëndrim që gjatë periudhës së kaluar ishte thënë në të gjitha konsultimet publike për legjislativin mediatik.

Gazetarët mund ti ndjekin seancat e Parlamentit me akreditim adekuat, edhe pse kjo, gjatë pesë viteve të fundit ishte shkelur në mënyrë flagrante. Shkelja më serioze e kësaj të drejte ndodhi më 24 dhjetor të vitit 2012, kur siguri i parlamentit i nxorri me forcë gazetarët nga galeria e mediave, prej ku po raportonin për sjelljen e Buxhetit për vitin 2013.

Qëllimi i Qeverisë së atëhershme ishte që ti pengojë gazetarët që të raportojnë për largimin e dhunshëm të deputetëve të opozitës nga seanca plenare, të cilët kishin bllokuar shqyrtimin për buxhetin duke pohuar se janë shkelur procedurat e Kuvendit për miratimin e tij.

Lidhur me këtë rast, pas shterrjes së të gjitha procedurave juridike në gjykatat e Maqedonisë, SHGM në vitin 2013 parashtrroi zyrtarisht ankesë deri tek Gjykata Evropiane për të drejtat e njeriut<sup>34</sup>. Në shkurt të këtij viti, Gjykata Evropiane solli vendim në favor të SHGM-së. Në vendimin e Gjykatës konstatohet se ka shkelje të dy të drejtave që garantohen me Konventën Evropiane për të drejtat e njeriut edhe atë: të drejtën e lirisë së shprehjes nga neni 10 dhe drejtën e gjykimit të drejtë nga neni 6 i Konventës<sup>35</sup>.

Rasti kishte bujë të madhe në opinionin e Maqedonisë dhe bashkësinë e ekspertëve, por ishte vërejtur edhe në nivel ndërkombëtar. Në kumtesën e SHGM-së lidhur me vendimin ishte theksuar se<sup>36</sup> “ky verdikt është i pari me të cilin vërtetohet cënimi i lirisë së shprehjes dhe është shumë i rëndësishëm për demokracinë dhe sundimin e së drejtës në Republikën e Maqedonisë. Njëkohësisht, verdikti është edhe një fitore e profesionit të gazetarisë i cili dëshmoi se gjithmonë duhet të luftojmë për drejtësi. Ndoshta drejtësia është e ngadaltë, por ajo gjithmonë fiton”

Më 27 prill të vitit 2017, ndodhi një sulm edhe më dramatik ndaj gazetarëve të cilët raportonin gjatë emërimit të kryetarit të ri të Kuvendit nga ana e shumicës së re parlamentare. Njerëz të afërët me partinë e atëhershme në Qeveri, të organizuar nën ombrellën e të ashtuquajturës iniciativë qytetare “Për Maqedoni të Përbashkët”, hynë me dhunë në Kuvend me qëllim që të ndërpresin konstituimin e Qeverisë së re e cila doli nga zgjedhjet e dhjetorit të vitit 2016

Simpatizuesit dhe përkrahësit e VMRO DPMNE-së përveç se i sulmuan deputetët e shumicës së re parlamentare, i kërcënuan dhe sulmuan edhe dhjetëra gazetarë, fotoreporterë dhe kameramanë, të cilët me orë të tëra, praktikisht ishin të kidnepuar nga turma e dhunshme, dhe nuk kishin asnjë mbrojtje policore. SHGM iu ofroi mbrojtje juridike të gjithë gazetarëve të cilët kanë qenë të sulmuar fizikisht dhe që kanë qenë pre e presioneve të ndryshme gjatë kryerjes së detyrës profesionale në Kuvend, ose u janë dëmtuar pajisjet<sup>37</sup>.

Shumica e gazetarëve janë të organizuar në organizata profesionale. Shoqata më e madhe dhe më e vjetër është SHGM-ja, e themeluar në vitin 1946, dhe është anëtare e Federatës Ndërkombëtare të Gazetarëve (FNG), si dhe Federatës Evropiane të Gazetarëve (FEG). Është një organizatë e pavarur joqeveritare dhe apolitike, e cila ka për qëllim të mbrojë dhe promovojë lirinë e shprehjes dhe gazetarinë etike<sup>38</sup>.

Prej vitit 2010, pas ndryshimeve në statutin e SHGM-së, kryesia e SHGM-së zgjidhet në zgjedhje të lira, në të cilat marrin pjesë të gjithë anëtarët e organizatës, sipas principit një anëtar-një votë.

Përveç Shoqatës së Gazetarëve të Maqedonisë, ekziston edhe i ashtuquajtur i Asociacioni maqedonas i gazetarëve (AMG), i formuar në vitin 2002 dhe i riaktivizuar në vitin 2013, me qëllim që ta legjitimojë rregullativën e re mediatike, të propozuar nga Qeveria

32 Ligji për Media, neni 2, alinea 4.  
33 “Ligji për media: Gazetarët me mendime të ndara lidhur me çështjen se kush është gazetar” Telegraf.mk, Telegraf.mk, 30 korrik 2016, qasur më 27 nëntor 2017: <http://www.telegraf.mk/aktuelno/makedonija/ns-newsarticle-19945-zakon-za-mediumi-novinarite-se-podelija-za-prasanjeto-koj-e-novinar.nsp.x>.  
34 Marulić Jakov Simona, “Gazetarët e Maqedonisë do ta kërkojnë drejtësinë në Strazbur” Balkan Inside, 5 korrik, 2014, qasur më 27 nëntor 2017: <http://www.balkaninsight.com/en/article/macedonian-journalists-to-seek-justice>.  
35 I gjithë teksti është në këtë lidhëze: [http://hudoc.echr.coe.int/eng/{"itemid":\["001-170839](http://hudoc.echr.coe.int/eng/{)

36 Shoqata e Gazetarëve të Maqedonisë, Fitoi drejtësia për gazetarët në Strazbur, Shkup, 2017, qasur më 27 nëntor, 2017: <http://znm.org.mk/?p=2998>.  
37 Shoqata e Gazetarëve të Maqedonisë, thirrje deri tek gazetarët që të padisin për dhunën në Kuvend, Shkup, 2017, qasur më 27 nëntor 2017: <http://znm.org.mk/?p=3245>.  
38 Informata lidhur me Shoqatën e Gazetarëve të Maqedonisë mund të gjendet në ueb faqen e saj: [http://znm.org.mk/?page\\_id=719&lang=en](http://znm.org.mk/?page_id=719&lang=en).

e mëparshme. Gjatë periudhës së shkruarjes së raportit, nuk është verejtur ndonjë aktivitet i kësaj shoqate. AMG nuk ka një Kodeks të Gazetarëve dhe nuk ka ueb faqe aktive në internet, për çka është e vështirë që të ndiqen aktivitetet e tij.

Një pjesë e gazetarëve dhe të punësuarve në media, janë anëtarë të Sindikatës së Pavarur të gazetarëve dhe punonjësve mediatic (SPGM)<sup>39</sup>, organizatë kjo e cila është themeluar në vitin 2010. Ky është sindikati i parë i gazetarëve në Maqedoni. Në vitin 2016, në media u paraqitën informata se do formohet një sindikatë e re e gazetarëve në të cilën do të anëtarësohen gazetar të afërt me partinë në pushtet. Ky sindikat megjithatë nuk u formuar për shkak se pushteti i mëparshëm kaloi në taborin opozitar dhe humbi kontrollin ndaj më shumë mediave në vend.

#### **A.5. Në çfarë niveli është mbrojtja juridike e burimeve të gazetarëve?**

Kushtetuta e Republikës së Maqedonisë e garanton të drejtën e fshehtësisë së burimit të gazetarit<sup>40</sup>, sipas të cilit, gazetari ka të drejtë që ta fsheh burimin e informatave dhe të mos thotë asnjë informatë me të cilën do zbulohet identiteti i tij.

Kjo çështje është e rregulluar edhe me Ligjin për Media. Në këtë ligj, mbrohet e drejta e fshehtësisë së burimeve, dhe ky ligj dikton që gazetari ta njoftojë redaktorin për burimin e informacionit.

Për nevojat e këtij hetimi, SHGM gjatë vitit të kaluar kishte analizuar Kodin Penal, dhe nuk gjeti kufizime lidhur me mbrojtjes e burimeve të gazetarëve. Është me rëndësi që të theksohet se edhe përkundër faktit që nuk ka kufizime, në vitin 2013, gjykata shfrytëzoi një normë tjetër ligjore lidhur me mospublikimin e identitetit të dëshmitarit të fshehur, për ta burgosur një gazetar. Kjo për shkak se ai gjatë procedurës hetimore, ka refuzuar që ta zbulojë burimin e tij për një storje të publikuar në vitin 2008.

Ligji për përgjegjësi civile për shpifje dhe fyerje e rregullon përgjegjësinë qytetare për dëmin e shkaktuar ndaj imazhit dhe dinjitetit të personave fizik dhe juridik, por megjithatë vërteton se gazetarëve nuk mund tu imponohet që ti zbulojnë burimet e tyre. Gjykata mund ti kërkojë gazetarit informata me të cilat mund të vërtetohet vërtetësia e pohimeve të publikuara, por pa u identifikuar burimi i informacionit.

Pasi këtë vit nuk ishte bërë asnjë intervenim në këtë pjesë të legjislativit, të gjithë përfundimet ose konkluzat nga raporti i vjetshëm mbesin të njëjta. Gjatë vitit 2017 nuk janë vërtetuar raste të reja të kërcënimit të fshehtësisë së burimit të informatave.

39 Informata për LSGM mund të gjenden në këtë ueb faqe: <http://ssnm.org.mk/?lang=en>.

40 Kushtetuta e Republikës së Maqedonisë, neni 16.

## **A.6. Cili është niveli i mbrojtjes së të drejtës për qasje deri tek informatat me karakter publik?**

Ligji për qasje të lirë deri tek informatat me karakter publik, ishte votuar në vitin 2006 dhe në disa raste ishte ndryshuar dhe plotësuar<sup>41</sup>. Vlerësimi i përgjithshëm është se Ligji nuk është tërësisht në harmoni me principet themelore të vërtetura në të drejtën ndërkombëtare. Afati 30 ditor për të marrë informata të karakterit publike është shumë i gjatë për gazetarët, ndërsa ekzistojnë shumë baza mbi të cilat institucionet ka gjasa që tua refuzojnë kërkesat gazetarëve për disa informata. Vitin e kaluar nuk ishte regjistruar ndryshim lidhur me konstatimet për punën dhe pavarësinë e Komisionit për qasje të lirë deri tek informatat e karakterit publik. Mbetet konstatimi i vitit të kaluar se ky komision ende nuk është i pavarur.

Gjatë hulumtimit të dytë, SHGM kërkoi qasje deri te informatat me karakter publik nga të gjithë ministrat dhe komunat të cilat vitin e kaluar, nuk kishin dhënë përgjigje në kërkesën tonë ose kishin thënë se gjatë vitit 2016 nuk kanë harxhuar para për reklamim.

Është indikative që vetëm 8 ministri dhe 13 komuna kanë kthyer përgjigje ndaj kërkesës sonë, që është një nivel jashtëzakonisht i ulët, dhe njëkohësisht është tregues për mënyrën se si zbatohet ky ligj në Maqedoni.

Kjo e dhënë vërteton konkluzën e raportit të vitit të kaluar se shumica e gazetarëve që kanë bërë kërkesë për qasje deri tek informatat me karakter publik, kanë patur përvojë negative me institucionet shtetërore. Madje 87% e gazetarëve të anketuar gjatë vitit 2016 që kishin marrë përgjigje në kërkesat e tyre, i kanë vlerësuar përgjigjet si gjysmake.

Intervistat me gazetarë të bëra për nevojat e raportit të këtij viti, vetëm i vërtetojnë gjetjet e vitit të kaluar. Ligji zbatohet shumë pak, gazetarët kanë përvojë negative dhe nuk kanë besim tek institucionet se do tua dorëzojnë informatat e kërkuara në kohë të arsyeshme. Siç pohon gazetari Zoran Fidanovski, në intervistën e bërë për nevojat e këtij raporti:

„Punë jotransparente të institucioneve, kundërshtim për bashkëpunim, frikë nga njerëzit se mos vallë po publikohet ndonjë situatë skandaloze, si dhe mungesa e mjeteve financiare dhe durimit të redaktorëve që të bëhen dhe fitohen kësi lloj storjesh, të cilat janë të domosdoshme për një shoqëri demokratike“<sup>42</sup>

<sup>41</sup> Ligji për qasje deri tek informatat me karakter publik

<sup>42</sup> Zoran Fidanovski, intervistë me anëtar të ekipit të SHGM-së, korrik 2017.



# B

## Pozita e gazetarëve në redaksi, etika profesionale dhe niveli i censurës.

Për nevojën e këtij grupi indikatorësh, të cilët e përpunojnë statusin ekonomik dhe social të gazetarëve, ishin intervistuar gazetarë, përfaqësues të organizatave mediatike, u zbatuan anketa dhe u shqyrtuan publikimi të këtij viti. Prej analizave u konkludua se ekzistojnë kufizime serioze të lirive të gazetarëve në Maqedoni, për çka pa dyshim, kontribuon statusi i dobët ekonomik dhe social i gazetarëve.

Mbetet një shqetësim serioz niveli i ulët i përqindjes së gazetarëve të cilët kanë një vend pune të sigurtë dhe benefite sociale e të punës. Shumica e gazetarëve kanë paga shumë të ulëta, dhe madje nën mesataren kombëtare, por ka edhe gazetar që pagat nuk i marrin me rregull.

Politikat e gabuara të Qeverisë së kaluar e cila shfrytëzonte paratë publike për financimin e mediave private, për ti kontrolluar politikat redaktuese, si dhe ndryshimet teknologjike për shkak të të cilave, mediat e shkruara po zhduken, shkaktuan trazira thelbësore në sektorin mediatik dhe i vendosën mediat në rreziqe të padëshiruara.

Në vitin 2017, tre gazetatat ditore më të mëdha në shtet, u mbyllën, dhe rreth njëqind gazetarë mbetën pa punë.

Por, nuk janë vetëm mediat e shkruara në rrezik. Në kushte kur tregu mediatik është i ngopur nga media të shumta të dobëta, ndërsa Qeveria është reklamuesi më i shpeshtë, shumica e mediave ekzistencën e tyre e shohin në krijimin e një raporti klientelist me Qeverinë.

Mediat e tilla anojnë kah Qeveria dhe kanë një nivel të lartë të vetëcensurimit, dhe ka rrezik që edhe ato të mbyllën, ndërsa gazetarët të largohen nga puna. Shpesh këta gazetarë kalojnë tek mediat online në të cilat ka një numër shumë të vogël të punësuarish. Kjo ndikon në kualitetin e materialeve që publikohen dhe shpesh edhe shkelen standardet profesionale dhe etike.

## **B.1. A keqpërdoret pozita ekonomike e gazetareve për ta kufizuar lirinë e tyre?**

Pozita ekonomike e gazetarit keqpërdoret për ta kufizuar lirinë e tij. Në Maqedoni, 85% e gazetareve kanë rrogë më të vogël se 500 euro në muaj, ndërsa 45% kanë rrogë edhe më të vogël se mesatarja shtetërore e cila është afro 370 euro, ose 22 808 denarë. Këto të dhëna burojnë nga analiza e Sindikatës së Gazetarëve dhe punonjësve mediatic e realizuar gjatë muajit korrik dhe gusht të vitit 2017, dhe ku ishin përfshirë 127 punonjës mediatic<sup>43</sup>. Sipas kësaj analize, më shumë se gjysma e gazetareve ose 54% prej tyre, nuk kanë marrëveshje punësimi në afat të pacaktuar, ndërsa 19% janë të angazhuar përkohësisht si punëtor me honorar.

Sa i përket pagesës së rregullt të pagës mujore të gazetareve, bazuar në hulumtimin e Sindikatës së Gazetarëve<sup>44</sup>, më shumë se 55% të gazetareve u janë vonuar rrogat. Kryetarja e Sindikatës Tamara Çausidis vlerëson se: „kushtet e punës së gazetareve dhe punonjësve mediatic nuk janë përmirësuar, në Maqedoni ka ofertë më të madhe të fuqisë punëtore dhe pronarët këtë e shfrytëzojnë për të ulur rrogat, për të larguar me lehtësi gazetar nga puna, për t'i dënuar dhe për të përdorur masa të tjera të presionit“. Komente të ngjashme japin edhe gazetarët e tjerë të intervistuar për nevojat e kësaj analize.

*„Gazetarët ballafaqohen me probleme të ndryshme kur është në pyetje liria e shprehjes, por edhe problemet ekzistenciale. Një numër i madh i gazetareve marin rrogë shumë më të ulët se sa mesatarja në nivel shtetëror. Shumica e gazetareve nuk kanë marrëveshje në afat të pacaktuar, por punojnë me kontratë në vepër i cili vazhdohet nga muaji në muaj. Gazetarët në një pjesë të mediave nuk e kanë pushimin e paraparë vjetor, por kanë vetëm dhjetër deri në pesëmbëdhjetë ditë pune, të cilat shndërrohen në ditë kalendarike dhe nuk ju paguhen mëditje për punë gjatë festave shtetërore“<sup>45</sup>*

Një numër i madh i gazetareve këtë vit e humbën punën në disa gazeta, dhe kaluan në mediat online, por edhe në profesione të tjera. Të dhënat tregojnë se këta gazetarë të cilët janë të punësuar në mediat online, kanë rroga shumë më të vogla se sa të punësuarit në televizione.

Arsyeja për këto rroga të vogla është pozita e dobët financiare e mediave online, të cilat kanë prodhimtari të dobët për shkak të numrit të vogël të gazetareve që punojnë në to. Por edhe interesi i publikut për të ndjekur ueb faqe argëtuese, si dhe ndarja e madhe e tregut. Përkundër faktit se të ardhurat e këtyre gazetareve janë shumë të ulëta, pagat janë edhe jo të rregullta dhe nuk kanë benefite sociale.

Numri i gazetareve dhe punonjësve mediatic mbetet i panjohur. Ekzistojnë indikatorë vetëm për sektorin audiovizuel. Sipas të shënave zyrtare të rregullatorit mediatic, në vitin 2016<sup>46</sup> numri total i të punësuarve në mediat radiodifuzive ka qenë 2416, ndërsa krahasuar me vitin 2015, ky numër ka qenë 2353. Shumica e këtyre personave në vitin 2016, ishin të punësuar në Radio Televizionin e Maqedonisë (gjithësej 836 të punësuar). Në sektorin privat numri më i madh i të punësuarve janë në pesë televizionet kombëtare, edhe atë 578 persona.

Edhe pse të gjithë radiodifuzerët kanë obligim ligjor që të punësojnë një përqindje të caktuar të gazetareve, ekzistojnë indikacione se në praktikë ky detyrim nuk respektohet.

43 LSGM, Rroga në media ka ngecur nën mesataren, Shkup, 2017, qasur më 27 nëntor, 2017: <https://ssnm.org.mk/%D0%BF%D0%BB%D0%B0%D1%82%D0%B0%D1%82%D0%B0-%D0%B2%D0%BE-%D0%BC%D0%B5%D0%B4%D0%B8%D1%83%D0%BC%D0%B8%D1%82%D0%B5-%D0%B7%D0%B0%D0%B3%D0%BB%D0%B0%D0%B2%D0%B5%D0%BD%D0%B0-%D0%BF%D0%BE%D0%B4-%D0%BF%D1%80/>.

44 Tamara Çausidis, intervistë me anëtar të ekipit të SHGM-së, korrik 2017.

45 Intervistë anonime të realizuar me gazetar nga medium privat, korrik 2017.

46 ASHMA, Analizë e tregut të shërbimeve audio dhe audiovizuele për vitin 2016 (Shkup: ASHMA, 2017), qasur më 27 nëntor, 2017: [http://avmu.mk/wp-content/uploads/2017/05/Analizaliza\\_na\\_pazarot\\_ns\\_sudio\\_i\\_audiovizuelni\\_mediumski\\_uslugi\\_za\\_2016\\_godina.-min.pdf](http://avmu.mk/wp-content/uploads/2017/05/Analizaliza_na_pazarot_ns_sudio_i_audiovizuelni_mediumski_uslugi_za_2016_godina.-min.pdf).

## **B.2. Cili është niveli i pavarësisë redaktuese nga pronarët e mediave dhe organeve drejtuese?**

Mbetet e panjohur nëse ekzistojnë media private me akte të miratuara për organizim të brendshëm me të cilat, menaxhmenti ndahet nga redaksia e gazetarëve. Megjithatë, edhe përkundër faktit që këto sektore në praktikë janë si të veçanta, anketat e vitit të kaluar të realizuara nga SHGM tregojnë se niveli i përzierjes ose ndikimit në punën e redaksive nga ana e menaxhmentit është shumë i lartë. Kjo ndikon në mënyrë negative tek politika redaktuese respektivisht tek mënyra e raportimit të gazetarëve. Lidhur me këtë, Tamara Çausidis, kryetare e sindikatës së gazetarëve thekson:

„Termi tekst promovues ose intervistë është diçka për të cilën tashmë askush nuk reagon në kontekst negativ, dhe madje vlerësohet si diçka shumë normale. Nëse pronari i mediumit është në të njëjtën kohë edhe pronar i spitalit për shembull, në atë medium faqet e para dhe kryesore i rezervohen teksteve promovuese për këtë spital”

Ekspertët dhe gazetarët e intervistuar vlerësojnë se mediat nuk raportojnë negativisht për ata të cilët kanë reklama tek ai medium, ndërsa faji pjesërisht për këtë është tek mënyrë me të cilën nuk janë theksuar marrëdhëniet mes redaktorëve dhe pronarëve. Kështu gazetari Darko Çekеровski thotë:

„Pronari duhet të jetë përgjegjës për politikat financiare dhe të biznesit. Dhe duhet ta respektojë integritetin dhe lirinë e vendosjes së redaktorit. Pa iu përzier në vlerësim, përzgjedhje ose redaktim të teksteve të gazetarëve: të kenë të nënshkruar një marrëveshje me të cilën rregullohen të gjithë obligimet dhe të drejtat e redaktorit<sup>47</sup>”.

Mediat nuk kanë kode të brendshme etike, me përjashtim të RTVM-së i cili u soll këtë vit, por me lëshime të shumta. Kritika më e madhe e SHGM-së ishte se në të përzihet etika gazetareske me disiplinën në punë. Mediat private formalisht nisen nga Kodi Etik i gazetarëve të Maqedonisë, i miratuar në vitin 2001. Në shtator të këtij viti, SHGM dorëzoi mbi 300 kopje të Kodit<sup>48</sup> në gjashtë gjuhë të ndryshme, në thuajse të gjithë redaksitë e Maqedonisë. Qëllimi ishte që të promovohen standardet themelore gazetareske, sidomos gjatë periudhës së fushatës parazgjedhore për zgjedhjet locale të caktuara për mesin e muajit tetor të këtij viti.

Sipas gazetarëve të intervistuar, madje edhe kur ekzistojnë rregulla të definuara që garantojnë pavarësinë redaktoriale, ata në princip nuk respektohen në praktikë. Mediat rrallë herë shkruajnë në mënyrë kritike për klientët e tyre, e rrallë herë shkruajnë në mënyrë kritike për Qeverinë, e cila gjatë viteve të kaluara paraqitej si një prej reklamuesve më të mëdhej në pjesën më të madhe të mediave. Në këtë drejtim, Mlladen Çadikovski, kryeredaktor i televizionit 24 Vesti, thotë: „Për fat të keq, Kodi i gazetarëve nuk përdoret, ndërsa është dokumenti i vetëm, dhe i njëjti është i harmonizuar me principet e Federatës Ndërkombëtare të gazetarëve<sup>49</sup>”.

Pjesa më e madhe e mediave me ndikim janë anëtare të Këshillit të Etikës në mediat e Maqedonisë (KEM), një trup i vetërregullimit, i themeluar në vitin 2014. Ata formalisht janë të obliguar që ti përmbahen Kodit të Gazetarëve. Përveç Kodit, mbi 90 media private janë obliguar që do ta respektojnë Kartën për raportim etik gjatë procesit zgjedhor<sup>50</sup>. Megjithatë, disa prej mediave më me ndikim në formësimin e mendimit publik, shpesh i thejnë këto principe.

Ekzistojnë forma të ndryshme të presionit direkt të pronarëve të mediave ndaj menaxherëve dhe gazetarëve, madje edhe kërcënime për largim nga puna dhe kërcënime për dhunë fizike. Ky është një faktor tejet i fortë për vetëcensurë tek gazetarët. Në njërin prej intervistave thuhet:

„Forma më e shpeshtë e presionit kur gazetari refuzon të kryejë ndonjë detyrim është dënimi financiar ose në disa raste të rralla edhe përjashtim nga puna. Shpesh përdoret metoda e marginalizimit të ndonjë gazetari, sidomos degradimi dhe vendosja e tij në nivelin e fillestarit sipas shkallës profesionale<sup>51</sup>”.

47 Tamara Çausidis, intervistë me anëtar të ekipit të SHGM-së, korrik 2017.

48 Shoqata e gazetarëve të Maqedonisë, SHGM siguroi Kodin Etik të Mediave në Maqedoni, Shkup, 2017, qasur më 27 nëntor, 2017: <http://znm.org.mk/?p=3776>.

49 Mlladen Çadikovski, intervistë me anëtar të ekipit të SHGM-së, korrik 2017.

50 LSGM, Karta për raportim etik gjatë zgjedhjeve, Shkup, 2017, qasur më 27 nëntor, 2017: <http://semm.mk/novosti-4/2015-08-11-15-03-18/499-povelba-za-etichko-izvestuvanje-za-izborite>.

51 Gazetar i cili dëshiron të mbetet anonim, intervistë me anëtar të ekipit të SHGM-së, korrik 2017.

### B.3. Cili është niveli i pavarësisë redaktuese të gazetarëve në servis publik?

RTVM në vitin 2017, si obligim që buron nga statuti dhe pas shumë paralajmërimeve, miratoi Kodin e gazetarëve, kuadrat kreative dhe të gjithë të punësuarit në RTVM<sup>52</sup>.

Ky Kodeks ishte pre e shumë kritikave nga ana e forumit lokal të gazetarisë i cili kontestonte përmbajtjen e dokumentit, por edhe vetë qasjen e udhëheqësisë së RTVM-së, para së gjithash për shkak të mungesës së transparencës në procesin e përpilimit të Kodit. Më së shumti mangësi Kodi ka në përzierjen e etikës gazetareske me disiplinën në punë, me të drejtat dhe obligimet e gazetarëve që burojnë nga Ligji për Marrëdhënie pune<sup>53</sup>.

SHGM-ja i pati dorëzuar shënime lidhur me draft verzionin e Kodit Etik dhe i rekomandoi që të përpilohen dy dokumente të veçanta, njëri për sjelljen etike të gazetarëve sipas modelit të Federatës Ndërkombëtare të gazetarëve, ndërsa tjetri dokument për të punësuarit e tjerë respektivisht për ekipin teknik dhe profesional të RTVM-së. Përpos Kodit Etik, RTVM-ja ka edhe Statut si një dokument juridik i cili buron nga obligimi ligjor i Radio Televizionit të Maqedonisë që ti rregullojë çështjet e vendosjes organizative për funksionim të brendshëm. Sipas statutit, RTVM duhet të miratojë edhe 16 akte të tjera, përfshirë këtu edhe atë për organizim të brendshëm. Në praktikë gazetaret dhe redaksitë janë të pavarura, dhe më së shpeshti janë nën ndikim direkt të redaktorëve dhe menaxhmentit, dhe në shumicën e rasteve edhe nën ndikim të funksionarëve të lartë shtetëror. Prandaj, për shkak të këtyre ndikimeve, RTVM ishte lëndë e kritikave për mungesë informimi në kohë për incidentin në Kuvend më 27 prill të këtij viti.

Agjencia për Shërbime Audio dhe Audio Vizuele i dorëzoi RTVM-së një shënim në të cilin ishte theksuar mënyra e informimit të saj lidhur me këto ngjarje, si një servis publik, nuk i ka plotësuar obligimet e saj ligjore:

*„Servisi publik nuk siguroi informim në kohë lidhur me ngjarjet në Kuvend, një pjesë e paraqitjeve të reporterëve nuk ishin në pajtueshmëri me rolin edhe funksionin e servisit publik dhe nuk ishin organizuar programet aktuale-informative në të cilat do të debatohej për këto ngjarje shoqëro-politike që janë në interes të lartë publik. Kjo sidomos ka të bëjë me obligimet për: të siguruar informim në çdo*

*kohë, informim të plotë, të paanshëm, të drejtë për të gjithë ngjarjet politike dhe të tjera në Republikën e Maqedonisë<sup>54</sup>“.*

Presioni që u bëhet gazetarëve të RTVM-së dallon nga ai që e durojnë gazetaret të cilët punojnë në mediat komerciale. Në RTVM, gazetaret para së gjithash ndiejnë një presion të brendshëm i cili zbatohet me masa disiplinuese të shqiptuara nga eprorët, me dënime në para, rivendosje në vende të tjera të punës dhe ngjashëm. Kategoria më e rrezikuar janë korrespondentët të cilët janë pak në numër dhe më së shpeshti janë të angazhuar me marrëveshje të përkohshme, që mund të anulohen me lehtësi, gjë që ka ndodhur viteve të fundit.

Përveç kësaj, gjatë periudhës që po shqyrtohet në këtë raport, RTVM ende ishte nën ndikimin e strukturave të Qeverisë që i përkisnin VMRO DPMNE-së. Lidhur me këtë, një prej ekspertëve të intervistuar vlerëson:

*“Servisi publik ende është nën ndikimin e fortë të Qeverisë së mëparshme. Struktura udhëheqëse dhe redaktuese është e njëjta nga periudha e kaluar. Kjo mund të duket qartë edhe nga programi i RTVM-së<sup>55</sup>“.*

### B.4. Cili është niveli i pavarësisë së gazetarëve në sektorin jo fitimprurës?

Një pjesë e mediave informative online janë të regjistruara si shoqata qytetarësh<sup>56</sup>, respektivisht si organizata civile, por megjithatë deri më tani nuk është bërë ndonjë analizë për punën e tyre dhe për statusin e pavarësisë së gazetarëve në redaksitë e këtij lloji.

Interesi kryesor i një pjese të mediave të regjistruara në këtë formë, është që të kenë mundësi të aplikojnë në thirrjet për ndihmë financiare prej donatorëve ndërkombëtar. Këto media kanë redaksi të vogla të përbëra prej vetëm disa gazetarëve dhe kanë tendencë të merren kryesisht me gazetari hulumtuese prandaj edhe janë të regjistruara si subjekte juridike jofitimprurëse pasi rrallë herë vërehen nga sektori komercial kur ka nevojë për reklama dhe shpallje.

52 RTVM, "Kodi etik i RTVM-së për gazetaret, kuadrat creative dhe për të gjithë të punësuarit në RTVM", Shkup: 2017, qasur më 29 nëntor, 2017: [http://www.mrt.com.mk/sites/default/files/%D0%95%D1%82%D0%B8%D1%87%D0%BA%D0%B8%20%D0%BA%D0%BE%D0%B4%D0%B5%D0%BA%D1%81%20%D0%BD%D0%B0%20%D0%9C%D0%A0%D0%A2\\_0.pdf](http://www.mrt.com.mk/sites/default/files/%D0%95%D1%82%D0%B8%D1%87%D0%BA%D0%B8%20%D0%BA%D0%BE%D0%B4%D0%B5%D0%BA%D1%81%20%D0%BD%D0%B0%20%D0%9C%D0%A0%D0%A2_0.pdf)

53 Shoqata e Gazetarëve të Maqedonisë, "Të prolongohet sjellja e Kodit Etik të RTVM-së", Shkup, 2017, qasur më 27 nëntor, 2017: <http://znm.org.mk/?p=3102>.

54 Agjencia për Shërbime Audio dhe Audiovizuele, Shkresë deri tek RTVM-ja, Shkup: 3 Maj, 2017, qasur më: 27 nëntor, 2017: [http://trinity.mk:53000/wp-content/uploads/2017/05/Dopis\\_do\\_Programski\\_sove\\_t\\_na\\_MRT.pdf](http://trinity.mk:53000/wp-content/uploads/2017/05/Dopis_do_Programski_sove_t_na_MRT.pdf).

55 Snezhana Trpevska, intervistë me anëtar të ekipit të SHGM-së, korrik 2017.

56 Pina.mk, Prizma.mk, NovaTv, BIRN, janë mediat më të njohura të regjistruara si organizata jofitimprurëse“.



Ajo që bie në sy është se në ato disa ueb portale të cilat publikojnë storje hulumtuese lidhur me keqpërdorimet e Qeverisë, ishin pre e sulmeve të shpeshta nga mediat armike dhe por edhe partive politike dhe individëve. Një instrument tjetër për presion ndaj këtyre mediave në kohën kur në Qeveri ishte VMRO DPMNE-ja, ishte padia për Fyerje dhe Shpifje nga funksionarë shtetëror të cilët gjatë padive të tyre, paraqisnin shuma të mëdha si dëmshpërbim jomaterial, për shkak të siç kualifikohet, dhimbjes shpirtërore. Në vitin 2017 thuajse nuk është shënuar asnjë rast i tillë por duhet marrë parasysh se prej qershorit të këtij viti, VMRO DPMNE më nuk është në Qeveri.

### **B.5. Sa kanë liri gazetarët në procesin e prodhimit të lajmeve?**

Niveli i vetë-censurës tek gazetarët e Maqedonisë është në nivelin më të lartë në rajon, nëse merren parasysh indikatorët e lirisë së gazetarëve dhe mediave nga organizata të besueshme mediatike<sup>57</sup>. Për fat të keq, për shkak të ambientit jo të sigurtë në të cilin punojnë gazetarët dhe praktikën e mosndëshkimit, si dhe kushtet e këqija në të cilat punojnë, gazetarët thuajse nuk kanë mundësi që në liri të plotë ti zgjedhin temat për të cilat do të raportojnë, e sidomos kjo gjë duket tek redaksitë më të mëdha, përfshirë këtu edhe RTVM-në.

Gazetarët poashtu, rrallë herë paraqesin raste të presionit ose censurës direkte dhe kur ta bëjnë këtë gjë, më së shpeshti kërkojnë që të mbeten anonim nga frika e përgjashimit nga puna. Kjo para së gjithash ndodh tek gazetarët që punojnë në media më të vogla, më së shpeshti në nivel rajonal ose lokal. Për këtë shkak SHGM dhe LSGM janë penguar që të ngrisin padi, ti shfrytëzojnë mjetet e tjera juridike ose të bëjnë presion presion publik.

Në hulumtimin e vitit të kaluar të zbatuar për nevojat e analizës së parë, më shumë se gjysma e të anketuarve vlerësojnë se kryesia ndikon në punën e tyre, ekziston më shumë liri për përzgjedhjen e lajmeve por censura është e lartë. (faqe. ?39-39)<sup>58</sup>.

57 Sipas raportit të fundit të Freedom House, Maqedonia në vitin 2016 ishte në grupin e vende me media të robëruara. Raportin mund ta gjeni në linkun e ueb faqes: <https://freedomhouse.org/report/freedom-world/2017/macedonia>.

?Lajmet dhe këndi i storjeve, ose 55% e gazetarëve vlerësojnë se censura në një masë të caktuar ndikon në punën e tyre, sidomos në redaksitë më të mëdha, fare nuk marrin pjesë ose kanë shumë pak pjesëmarrje në krijimin e lajmeve.

Një prej gazetarëve me të cilët është bërë intervistë këtë vit lidhur me këtë problem<sup>59</sup>, thotë:

*“Më së shpeshti ngjarjet dhe temat i dikton vetë dita, dhe nuk ndodhë e kundërta që gazetarët të imponojnë tema për të cilat do të hapej debat. Rolin kryesor e ka kryeredaktori i cili në varësi prej mediumit ku punon, ashtu edhe vepron. Nëse është medium proqeveritar, atëherë redaktori ndikon shumë pak në përmbajtjen e lajmeve pasi që merr direktiva nga partitë politike, por nëse është i punësuar në medium kritik, atëherë ka më shumë hapësirë të mbledhë dhe selekton ide të gazetarëve”*

Duhet theksuar se praktika e tillë më së shpeshti duket në mediat në të cilat nuk nxitet gazetaria kritike dhe hulumtuese. Në këtë drejtim, komenti i gazetarit Mlladen Çadikovski është tejet ilustrues:<sup>60</sup> “Në mediumin në të cilin unë jam kryeredaktor, gazetarët nxiten dhe inkurajohen që të propozojnë tema, të cilat më pas i diskutojmë në kolegjiun. Dyshoj se ka situatë të tillë në mediat e tjera kombëtare”

Përzgjedhja e temave për raportimin në mediat rajonale dhe lojale është edhe më problematik për gazetarët për shkak të hapësirës së vogël në të cilën funksionojnë këto media, dhe për shkak të lidhjeve të theksuara klienteliste të pronarëve me kryetarët e komunave dhe njerëzit e tjerë të fuqishëm lokal. Në këtë drejtim, Ivan Bojaxhiski m ush korrespondent i gazetës “Utrinski”<sup>61</sup> thotë: “Liria gazetareske është liria prinarit të mediumit të tregojë se çfarë është e çfarë jo përzgjedhje teme për të cilën duhet raportuar. Gazetarët janë të lirë vetëm kur kanë të bëjnë me lajme për çmimet e domateve dhe kastravecëve në treg”

58 Shoqata e gazetarëve të Maqedonisë” Indikatorë të nivelit të lirisë së mediave dhe sigurisë së gazetarëve. [MAQEDONI], Shkup, 2017, qasur më 27 nëntor 2017: <http://znm.org.mk/wp-content/uploads/2016/03/%D0%98%D0%B7%D0%B2%D0%B5%D1%88%D1%82%D0%B0%D1%98-%D0%9F%D0%BE%D0%BA%D0%B0%D0%B7%D0%B0%D1%82%D0%B5%D0%BB%D0%B8-%D0%B7%D0%B0-%D1%81%D1%82%D0%B5%D0%BF%D0%B5%D0%BD%D0%BE%D1%82-%D0%BD%D0%B0-%D1%81%D0%BB%D0%BE%D0%B1%D0%BE%D0%B4%D0%B0-%D0%BD%D0%B0-%D0%BC%D0%B5%D0%B4%D0%B8%D1%83%D0%BC%D0%B8%D1%82%D0%B5-%D0%B8-%D0%B1%D0%B5%D0%B7%D0%B1%D0%B5%D0%B4%D0%BD%D0%BE%D1%81%D1%82%D0%B0-%D0%BD%D0%B0-%D0%BD%D0%BE%D0%B2%D0%B8%D0%BD%D0%B0%D1%80%D0%B8%D1%82%D0%B5-%D0%9C%D0%9A-%D0%B4%D0%B5%D0%BA%D0%B5%D0%BC%D0%B2%D1%80%D0%B8-2016.pdf>

59 Gazetar i cili dëshiron të mbetet anonim, intervistë me anëtar të ekipit të SHGM-së korrik, 2017.

60 Mlladen Çadikovski, intervistë me anëtar të ekipit të SHGM-së korrik, 2017.

61 Ivan Bojaxhiski, intervistë me anëtar të ekipit të SHGM-së korrik, 2017.





# Siguria dhe statistika e mosndëshkimit

Në Maqedoni nuk është e garantuar siguria e gazetarëve gjatë kryerjes së obligimeve të tyre profesionale. Në mënyrë që të pengohen për të raportuar mbi keqpërdorimet e Qeverisë, ata vazhdimisht janë pre e presioneve, kërcënimeve dhe sulmeve. Politika e mosndëshkimit të dhunës kundër gazetarëve është arsyeja kryesore për gjendjen e keqe të lirisë së shprehjes në Maqedoni. Për shkak të persekutimit të gazetarëve, Freedom House Maqedoninë e trajton si një shtet me regjim hibrid, me media të robëruara.

## C1. Statistika për siguri dhe mosndëshkim

Vitin e fundit, gjatë periudhës prej shtatorit të vitit 2016 e deri në fund të gushtit të këtij viti, dhuna ndaj gazetarëve ka vazhduar pothuajse me intensitetin e njëjtë sikurse në vitet e kaluara. Krahasuar me gjashtë muajt e parë të vitit 2016, këtë vit ka më pak sulme, por ato ishin më direkte dhe më brutale. Nëse deri vjet, Qeveria e kaluar e VMRO DPMNE-së tentonte të paktën formalisht të distancohet nga sulmet për ta fshehur lidhshmërinë me sulmuesit, në pjesën e parë të vitit 2017, kjo lidhshmëri tashmë u bë e dukshme. Në forma të ndryshme të sulmeve ndaj gazetarëve, u kyçën edhe funksionarë shtetëror dhe partiak të VMRO DPMNE-së si dhe simpatizuesit, përkrahësit, organizatorët e shoqatave civile të tyre e të tjerë.

Në periudhë prej një viti, Shoqata e Gazetarëve regjistroi gjithësej 18 sulme ndaj gazetarëve me çka numri total i sulmeve fizike në katër vitet e fundit u rrit në mbi 50.

Këtë vit, prej 18 sulmeve, 6 ishin sulme fizike, nëdrsa 7 ishin sulme verbale, ndërsa pesë sulmet e tjera kanë të bëjnë me fyerje, pengesa për raportim nga ndonjë ngjarje publike ose prishja e pronës private të gazetarëve.

Sipas Këshillit të Evropës, Maqedonia bie në grupin e vende evropiane me regjime autoritare, siç janë Rusia, Turqia dhe Azerbejxhani, ku ende ka gazetarë të burgosur. Gazetari Zoran Bozhinovski për një vit e gjyasmë ishte mbajtur në paraburgim, pasi në prill të vitit 2016, ishte ekstraduar në mënyrë të paligjshme nga Serbia, si i dyshuar për vepra penale të spiunimit, bashkimit kriminel dhe shantazhimit.

Këtë vit, kah mesi i korrikut, tre ditë para skadimit të afatit për mbajtje në paraburgim, Bozhinovski ishte lënë të mbrohet në liri. Ky vendim nuk ishte rezultat i vullnetit të mirë të gjykatës, por për shkak të pamundësisë ligjore që ti vazhdohet paraburgimi gazetarit edhe për 30 ditë të tjera.

SHGM e ka ndjekur nga afër gjykimin e tij, dhe ka vërejtur se prokurori në disa seanca gjyqësore, nuk ka arritur që ta dëshmojë fajësinë e tij. Përkundrazi, disa nga dëshmitarët e Prokurorisë kanë dëshmuar në favor të Bozhinovskit.

Teksa Bozhinovski ishte në paraburgim, SHGM vazhdimisht bënte thirrje publike deri tek organet gjyqësore që ta shfuqizojnë masën e paraburgimit, pasi që nuk kishte asnjë arsye serioze për një gjë të tillë. Për këtë qëllim, në shtator të vitit 2016 ishte organizuar një protestë para Gjykatës Themelore Shkup 1 në Shkup, por gjykatësi injoroi thirrjet e gazetarëve që kolegu i tyre t mbrohet në liri.

Prej gjashtë sulmeve fizike ndaj gazetarëve që kanë ndodhur gjatë vitit të kaluar, njëri është më serioz. Më 27 prill pasi që shumica parlamentare zgjodhi kryetar të Kuvendit, përkrahësit e ish kryeministrit Nikola Gruevski hynë në Kuvend me qëllim që të pengojnë konstituimin e Qeverisë së re që doli nga zgjedhjet e parakohshme të muajit dhjetor.

Ata, jo vetëm që i sulmuan fizikisht deputetët e shumicës parlamentare, por mllëfin e tyre e hodhën edhe mbi gazetarët të cilët raportonin për punën e Parlamentit. Mib 20 gazetar ishin sulmuar fizikisht, të frikësuar me armë, ishin penguar që të raportojnë nga ngjarja, dhe u ishte marrë dhe shkatërruar pajjsja.

Atë mbrëmje, raportuesit nga Kuvendi isht praktikisht të kidnapuar nga ata dhunues, ndërsa policia me orë të tëra refuzonte tu japë mbrojtje. Për këtë incident, prokuroria ende po zhvillon hetim, po bisedon me gazetarët e dëmtuar por deri më tani nuk janë ngritur akuza. Gjashtë gazetarë kanë raportuar në SHGM se atë natë kanë qenë të sulmuar, ndërsa policia ka edhe informatë zyrtare dhe atë natë një gazetar e televizionit Alsat-M ka qenë e lënduar dhe këto lëndime më pas i ka konstatuar edhe mjeku.

Por, policia nuk ka përgjigje se kush e ka sulmuar gazetaren, dhe pas nuk është ngritur ndonjë hetim lidhur me këtë gjë. SHGM iu siguroi gazetarëve të lënduar ndihmë juridike, avokat, me qëllim që ti mbrojnë të drejtat e tyre para organeve gjyqësore.

Sulmit në Kuvend i paraprinë protesta të përditshme në kryeqytet, të organizuara nga iniciativa qytetare "Për Maqedoni të përbashkët", pas së cilës qëndronte partia në pushtet VMRO DPMNE. Ata kundërshtonin faktin që partia opozitare LSDM, të formojë koalicionin me partitë shqiptare, pasi që kjo do të nënkuptonte federalizimin e Maqedonisë. Kah fundi i muajit mars, pas mbarimit të marshit protestues nëpër rrugët e Shkupit, pjesëmarrës në protestë e kanë sulmuar fizikisht ekipin e portalit A1On<sup>62</sup>. SHGM e dënoi këtë sulm dhe e thirri liderin e VMRO DPMNE-së që tu apelojë përkrahësve të tij që të mos sulmojnë gazetar. Policia ka arritur ta zbardhë këtë suëm dhe ngriti padi para Prokurorisë Publike. Kundër një personi u ngrit padi penale për dhunë.

Sulmi i tretë më serioz ndaj një gazetari ndodhi në tetor të vitit të kaluar, para Ministrisë së Punëve të Brendshme. Gazetari i Televizionit Telma Pavle Bellovski<sup>63</sup> ishte sulmuar fizikisht nga një person me dosje kriminale teksa po raportonte për kontrollin e Prokurorisë Speciale në hapësirat e Drejtorisë për Siguri dhe Kundërzbulim, lidhur me skandalin e përgjimit.

Policia ka arritur që ta identifikojë sulmuesin dhe ka parashtruar procedurë kundërvajtëse për sulm fizik.

<sup>62</sup> Shoqata e gazetarëve të Maqedonisë "SHGM: Të mos raportohet nga protesta të dhunshme" Shkup, 2017, qasur më 27 nëntor, 2017: <http://znm.org.mk/?p=3043>.

<sup>63</sup> Shoqata e Gazetarëve të Maqedonisë, "Sulmi ndaj Bellovskit është i orkestruar nga struktura të MPB-së" Shkup, 2017, qasur më 27 nëntor, 2017: <http://znm.org.mk/?p=2754>

Një sulm i pazakontë fizik ndodhi në prill të këtij viti, kur përkrahës të shoqatës patriotike “Pere Toshev” nga Prilepi, të afërt me partinë e atëhershme qeverisë, tentuan që të përlëshen fizikisht me gazetarin e portalit Plusinfo, Bozhidar Barllakoski<sup>64</sup>, në mes të qendrës së kryeqytetit. Sulmuesit e kishin ndjekur Barllakovskin gjithandej rrugëve të Shkupit, por ai kishte arritur që tu ikë. Policia nuk ka informata lidhur me këtë incident.

Këtë vit, fizikisht janë sulmuar dy gazetarë, nga njerëz të afërt me partinë opozitare VMRO DPMNE, teksa po raportonin nga terreni. Në gusht, ekipi i gazetarëve të portalit NOVA TV ishte sulmuar fizikisht nga anëtar i “Iniciativës Qytetare”, kundër ndërtimit të kampeve për rerugjat në Maqedoni.

Gazetarja Sashka Cvetkovska<sup>65</sup> ishte sulmuar fizikisht teksa kishte tentuar të filmojë anëtarë të kësaj iniciative që mblidhnin nënshkrime për referendum kundër ndërtimit të kampeve për refugjatë.

Gazetarja po hulumtonte lidhjes mes gjoja iniciativës qytetare dhe kryetarit të komunës Aerodrom nga Shkupi, Ivica Konevski, i cili është nga radhët e VMRO DPMNE-së opozitare.

Ajo zbuloi se pas kësaj iniciative qëndrojnë të punësuarit e komunës dhe këshillat e arsimitarëve nga shkollat fillore të komunës, të cilët mblidhnin nënshkrime gjatë orarit të punës dhe përdornin pajisjet e shkollës. Policia e kishte identifikuar sulmuesin gjatë ditës së nesërme dhe menjëherë e kishte thirrur në bisedë informative në stacion policor. Nuk ka informata për masat e mëtutjeshme që i ka ndërmarrë policia.

Një sulm i ngjashëm ka ndodhur edhe në qershor në qytetin e Shtipit, ku ekipit të televizionit 24Vesti, nuk i ishte lejuar inçizimi i punimeve të ndërtimitarëve në objektin e Qendrës Tregtare. Sigurimi privat i Qendrës Tregtare ka përdorur dhunë fizike kundër gazetarit Ivan Kamçev<sup>66</sup>, me qëllim që ta pengojë të filmojë kronikë. Gazetarit i janë drejtuar edhe kërcënime verbale dhe i është dëmtuar edhe kamera. Nuk ka informata për veprimet e mëtutjeshme të policisë.

Përveç sulmeve fizike, gjatë vitit të fundit në Maqedoni janë regjistruar edhe shtatë sulme verbale dhe kërcënime ndaj gazetarëve. Këto sulme ishin të koordinuara nga partia e mëparshme qeverisë e cila gjatë asaj periudhe bënte fushatë të rreptë kundër gazetarëve dhe mediave kritike, duke i akuzuar për tradhëti të interesave kombëtare. Në këtë fushatë të VMRO DPMNE-së ishin kyçur edhe funksionarë shtëror dhe partiak të cilët në mënyrë agresive kërcënonin gazetarët, madje edhe me likuidim. Në dy raste më serioze të sulmit verbal, kishte edhe kërcënime të qarta me vdekje, thirrje për dhunë dhe gjuhë të urrejtjes.

Në janar, drejtori i Arkivit të Maqedonisë Filip Petrovski<sup>67</sup> i lëshoi një porosi zanore në Fejsbuk në të cilën bënte thirrje që përfundimisht të nisë qërimi i hesapeve me mediat e financuara nga Fondacioni Soros. Porosia ishte në shembull eklatant i thirrjes për linç kundër gazetarëve kritik.

Në këtë kontekst, Petrovski në mënyrë metaforike thirret në personalitete kontroverse të historisë të cilët janë të njohur si atentatorë. Me këtë ai në mënyrë të qartë dërgoi mesazh se gazetarët që punojnë në këto media duhet të likuidohen.

Kërcënime edhe më të drejtpërdrejta ndaj gazetarëve në po të njëjtin muaj, lëshoi edhe aktori dhe drejtori artistik i Teatrit Maqedonas në Shkup Toni Mihajlovski<sup>68</sup>. Ai në profilin e tij në fejsbuk ka shkruar se “pa ju trembur syri” mund ta vrasë gazetarin Triçkovski i cili ishte një kritikues i ashpër i Qeverisë së VMRO DPMNE-së. SHGM kërkoi nga Prokuroria Publike që të ndjekë penalisht Mihajlovskin për gjuhë të urrejtjes dhe thirrje për dhunë fizike.

Në sulmet e fundit verbale, sulmohet integriteti i fizik i gazetarëve. Në korrik, kryetari i komunës Novo Sellë, Blazho Vellkov,<sup>69</sup> nga radhët e VMRO DPMNE-së, e pengoi fizikisht ekipin e gazetarëve të TV VIS nga Strumica që të raporton për seancën e Këshillit Komunal, në të cilën duhej të raportohet për shpalljen e një referendumi kundër hapjes së një miniere.

64 Shoqata e gazetarëve të Maqedonisë, “Dënojmë sulmin ndaj gazetarit Barllakovski”, Shkup, 2017, qasur më 27 nëntor, 2017: <http://znm.org.mk/?p=3195>

65 Shoqata e gazetarëve të Maqedonisë, “Dënojmë sulmin ndaj ekipit të NOVA TV”, Shkup, 2017, qasur më 27 nëntor, 2017: <http://znm.org.mk/?p=3678>.

66 Shoqata e gazetarëve të Maqedonisë, “SHGM dënon sulmet dhe kërcënimet ndaj gazetarëve të TV24Veski dhe Portalb” Shkup, 2017, qasur më 27 nëntor, 2017: <http://znm.org.mk/?p=3392>.

67 Shoqata e gazetarëve të Maqedonisë, “Dënojmë dhunën verbale të pushtetit ndaj gazetarëve” Shkup, 2017, qasur më 27 nëntor, 2017: <http://znm.org.mk/?p=2924>.

68 Shoqata e gazetarëve të Maqedonisë, “Dënojmë ashpër kërcënimet me jetë ndaj gazetarit Triçkovski”: <http://znm.org.mk/?p=3413>.

69 Shoqata e gazetarëve të Maqedonisë, “SHGM dënon sulmin ndaj ekipit të gazetarëve të TV VIS në Komunën Novo Sellë”, Shkup, 2017, qasur më 27 nëntor, 2017: <http://znm.org.mk/?p=3592>

Në po të njëjtin muaj, një incident i ngjashëm është shkaktuar nga aktivistë të partisë shqiptare në pushtet BDI<sup>70</sup> në komunën e Shkupit Çair. Ata me sulme verbale kanë penguar ekipin e Televizionit Shenja që të raportojë për problemet e pazgjidhura komunale në lagjen Dyqanxhik.

Ish ministri i drejtësisë dhe aktivist i partisë në pushtet BDI në komunën e Sarajit, Blerim Bexheti,<sup>71</sup> në korrik, nëpërmjet një personi të tretë ka dërguar kërcënime verbale deri tek gazetarja e portalit Portalb, Elida Zilbehari, që ta pengojë në publikimin e një teksti kritik për trazirat në partinë e tij amë.

Një incident të ngjashëm me gazetarë ka shkaktuar edhe deputeti dhe aktivisti i LSDM-së Esad Rahiq<sup>72</sup>, i cili në shkurt të këtij viti dërgoi kërcënim të hapur drejt gazetarëve që të kenë kujdes se çfarë po shkruajnë për vllaun e tij, i dyshuar për tregëti me drogë. Rahiq atëherë pati paralajmëruar se familja e tij ka shumë miq, dhe nuk mund të garantojë se si do të reagojnë ata nëse takojnë në rrugë ndonjë prej gazetarëve që ka shkruar informata të pavërtetuara për mikun e tyre.

Ish ministri i Ekologjisë Bashkim Ameti<sup>73</sup> ka kërcënuar verbalisht gazetarin e portalit Tetova Sot Rami Mislimi. Në shtator të vitit të kaluar, ministri i BDI-së është hidhëruar përse gazetari ka shkruar tekste kritike për punën e tij.

Forma e tretë e kërcënimit të sigurisë së gazetarëve në Maqedoni janë fyerjet dhe nënçmimet ndaj gazetarëve që vijnë nga përfaqësues të ndryshëm të Qeverisë.

Në Mars, Qeveria e atëhershme në largim VMRO DPMNE, ka bërë një fushatë të gjërë kundër gazetarëve dhe personave publik me qëllim që ti frikësojë dhe fyejë. Ishin organizuar persona të rinj, nga tre prej tyre me role të ndara, dhe ata shkonin nëpër shtëpitë e gazetarëve me qëllim që ti frikësojnë dhe nënçmojnë, duke i quajtur tradhëtarë.

Një prej shembujve më eklatant ishte “vizita e paralajmëruar” e tresheve patriotike në banesën e gazetarit Triçkovski<sup>74</sup>, ku tentuan të hyjnë me forcë dhe ti dërgojnë mesazh se ai është një tradhëtar dhe duhet të ketë turp për këtë.

Në këtë fushatë të frikësimit, në po të njëjtën javë, pësoi edhe gazetari Borjan Jovanovski<sup>75</sup>. Ai ishte kapur në një restorant nga tre persona të organizuar, të cilët fillimisht, publikisht e kishin quajtur tradhëtar, ndërsa më pas e kishin pështyrë në fytyrë. Ndaj këtyre provokimeve Jovanovski është përgjigjur me qetësi dhe i është shmangur konfliktit fizik.

Lidhur me këtë incident policia ka konstatuar se janë kryer shkelje të rendit dhe qetësisë publike. Nuk janë dorëzuar denoncime, pasi nuk janë identifikuar autorët, edhe pse incidenti ishte filmuar me celular dhe ishte publikuar në rrjetin social Youtube.

Në Maqedoni u bë tashmë praktikë që bartësit e funksioneve të larta shtetërore të fyejnë gazetarë. Në tetor të vitit të kaluar, zëvendës kryeministri për çështje ekonomike Vladimir Peshevski<sup>76</sup>, pas konferencës në Qeveri, në të cilën po i prezantonte sukseset e punës së tij, e ka quajtur prostitutë gazetaren e gazetës ditore “Vest” për shkak se ka parashtruar pyetje të pakëndshme.

Një incident i ngjashëm ka ndodhur me kryetarin e Këshillit Gjyqësor Zoran Karaxhovski,<sup>77</sup> i cili në shkurt të këtij viti, në deklaratë për media, raportimet e mediave për ndryshimin e vendit të punës së gjykatësve nga sektori penal në atë kundërvajtës i quajti si vullgaritete teatrale, ndërsa gazetarët i etiketoi si “të vetëquajtur gazetar”. Për shkak të këtij incidenti, SHGM kërkoi nga Karaxhovski që të kërkojë falje publike nga gazetarët.

70 Shoqata e gazetarëve të Maqedonisë, “Dënojmë sulmin verbal të simpatizuesve të BDI-së ndaj TV SHENJA”, Shkup, 2017, qasur më 27 nëntor, 2017: <http://znm.org.mk/?p=3573>

71 Shoqata e gazetarëve të Maqedonisë, “Dënojmë sulmin dhe kërcënimet ndaj gazetarëve të Tv24 dhe Portalb”, Shkup, 2017, qasur më 27 nëntor, 2017: <http://znm.org.mk/?p=3392>

72 Shoqata e gazetarëve të Maqedonisë, “Dënojmë kërcënimet e Rahiqit kundër gazetarëve”, Shkup, 2017, qasur më 27 nëntor, 2017: <http://znm.org.mk/?p=3026>

73 Здравение на новинарите на Македонија, “Осуда на законите на министерот Ахмети врз новинарот Мислими”, Скопје, 2017 пристапено ноември 27, 2017: <http://znm.org.mk/?p=2679>

74 “Të rinjtë deri tek Triçkovski. Si nuk ke turp, tradhëtar!”, YouTube, Për herë të fundit e ndryshuar më 1 mars, 2017, <https://www.youtube.com/watch?v=4L6glPy4PNI>

75 “Sulm ndaj Borjan Jovanovskit”, YouTube, Për herë të fundit e ndryshuar më 2 mars, 2017, [https://www.youtube.com/watch?v=p-Gp0FWNW\\_4](https://www.youtube.com/watch?v=p-Gp0FWNW_4)

76 Shoqata e gazetarëve të Maqedonisë, “Peshevski të japë dorëheqje pse ta shkarkojnë” Shkup, 2016, qasur më 27 nëntor, 2017: <http://znm.org.mk/?p=2776>

77 Defo Daniel, “Karaxhovski: PSP është infantile, gazetarët janë të njëanshëm”, Zhurnal.net 1 shkurt 2017. Qasur më 29 nëntor, 2017: <http://zurnal.net/?tag=%D0%B7%D0%BE%D1%80%D0%B0%D0%BD-%D0%BA%D0%B0%D1%80%D0%B0%D1%9F%D0%BE%D0%B2%D1%81%D0%BA%D0%B8>

## C.2. A marrin përgjegjësi aktorët politik dhe institucionet shtetërore për mbrojtjen e gazetarëve?

Ministria e Punëve të Brendshme në korrik të këtij viti, pas një kërkese me shkrim të SHGM-së, dorëzoi raport lidhur me sulmet ndaj gazetarëve gjatë pesë viteve të fundit. Sipas këtij raporti, gjatë pesë viteve të fundit policia ka regjistruar gjithësej 44 sulme, prej të cilëve 28 në Shkup, 14 në Ohër dhe 2 në Strumicë.

Prej 44 sulmeve, policia ka arritur që të zgjidhë dhjetë, për çka janë ngritur pesë procedura penale dhe pesë kundërvajtëse. Tre procedura penale janë ngritur për dhunë, ndërsa një për dëmtim të rëndë trupor, dhe një për zhatje.

Një pjesë e procedurave kundërvajtëse kanë të bëjnë me disa rrahje, ndërsa nga një për sulm fizik, për sjellje të pahijshme dhe për dehje.

MPB nuk ka vepruar për 21 sulme kundër gazetarëve për shkak se 16 sulmet që i ka regjistruar SHGM-ja, nuk ishin denoncuar në polici, ndërsa pesë raste janë paraqitur, por policia pohon se gazetarët nuk kanë dorëzuar të dhëna të mjaftueshme në mënyrë të MPB-ja të merr masa.

Prej të dhënave të dorëzuara, më së shumti vëmendje tërheqin 18 incidentet të cilët për pesë vite kanë ndodhur në Ohër, kundër pronarit të një ueb portali Sasho Denesovski. Ai për katër vite ka qenë pre e formave të ndryshme të kërcënimeve, sulmeve dhe presioneve. Sulmi më serioz ka ndodhur në vitin 2014 kur ai është sulmuar fizikisht dhe i janë kërkuar para, ndërsa në vitin 2015 ka qenë i sulmuar fizikisht nga njerëz të panjohur me shufra metalike. I janë shkaktuar dëmtime në pjesën e kokës dhe të duarve. Për këtë rast, MPB ka ngritur padi penale kundër personit të panjohur.

Në dhjetë vitet e fundit, në Maqedoni humbën jetën dy gazetar, në kushte dhe rrethana shumë të çuditshme dhe të paqarta. Edhe pse për të dy rastet në hetimin zyrtar thuhej se bëhet fjalë për vetëvrasje dhe aksident rrugor.

Rasti i parë tragjik ndodhi në vitin 2008 kur gazetari Vllado Tanevski, i dyshuar për një sërë vrasjesh në Kërçovë, gjoja se është vetëvararë në burgun e Tetovës<sup>78</sup>. Sipas raportit të obduksionit, ai është vetëvararë në qelinë e tij, duke u ngulatur në një kovë me uj. Raporti i tillë i obduksionit ngjalli debat në opinion për shkak të shpjegimit të palogjikshëm se si ka mundësi që një person të ngulafatet në një kovë me uj, por reagime zyrtare për këtë ngjarje kontroverse nuk kishte as nga Shoqata e atëhershme e gazetarëve e as nga opozita e dikurshme.

78 "Si ka arritur të ngulafatet në kovë", Veçer, 24 qershor 2008. Qasur më 27 nëntor, 2017: <http://vecer.mk/kako-uspeal-da-se-udavi-vo-kofa>.

Rasti i dytë tragjik ka ndodhur në vitin 2013 kur gazetari dhe pronari i javores së pavarur Fokus, Nikolla Mladenov<sup>79</sup> humbi jetën. Ai ndërroi jetë në afërsi të Shkupit, në një aksident rrugor. Hetimi zyrtar tregoi se bëhet fjalë për aksident komunikacioni dhe mohonte dyshimet e publikut se bëhet fjalë për vrasje<sup>80</sup>. Opozita e atëhershme LSDM, hodhi dyshime mbi hetimin zyrtar dhe besueshmërinë e tij, dhe publikonte informata se gjoja arsyeja e vdekjes së Nikolla Mladenovit nuk ka qenë aksidenti<sup>81</sup>. Përveç kësaj, SHGM atëherë kërkoi një hetim të pavarur me qëllim që të vërtetohet saktë se në cilat rrethana ka ndërruar jetë gazetari.

Gjatë vitit të kaluar, Shoqata e Gazetarëve të Maqedoni ishte objekt i sulmit verbal të partisë në Qeverinë e atëhershme VMRO DPMNE. Këtëvit, në një kumtesë publike<sup>82</sup>, kjo parti e sulmoi SHGM-në për akuzat të rrejshme dhe se gjoja po punon në interes të LSDM-së opozitare dhe fondacionit Soro.

Shënjestër e shpeshtë e sulmeve të Qeverisë së mëparshme ishte edhe kryetari i SHGM-së Naser Selmani. Në një kumtesë për publikun në mars të këtij viti<sup>83</sup>, VMRO DPMNE e akuzoi Selmanin se gënjen dhe manipulon publikun kur thotë se pas sulmeve ndaj gazetarëve qëndron pushteti.

Sulme të ngjashme publike<sup>84</sup> në llogari të SHGM-së dhe kryetarit të tij, VMRO DPMNE dërgonte publikisht edhe gjatë periudhës së mëhershme, me qëllim që ta cënojë imazhin dhe kredibilitetin e Shoqatës në emër të gazetarëve dhe opinionit. Kjo fushatë agresive dhe negative e Qeverisë së mëparshme kundër SHGM-së, ishte përkrahur edhe nga mediat proqeveritare<sup>85</sup>, të cilat përcillnin akuzat të rrejshme për gjoja përfshirjen e Shoqatës në aktivitetet për pastrim parash i cili asnjëherë nuk u dëshmuar.

79 "Gazetari i njohur Nikolla Mladenov humbi jetën në një aksident rrugor", Mkd.mk, 27 mars, 2013, qasur më 27 nëntor, 2017: <https://www.mkd.mk/crna-hronika/poznatiot-novinar-nikola-mladenov-zagina-vo-soobrakajna-nesrekja>

80 "Prokuroria e mbylli rastin Mladenov si aksident" 24Vesti, 10 korrik, 2013 qasur më 27 nëntor, 2017: <http://24vesti.mk/obvinitelstvoto-go-zatvori-sluchajot-mladenov-kako-nesrekja>

81 "Opozita me të dhëna shokuese për vdekjen e Mladenovit" Faktor, 7 maj, 2015. Qasur më 27 nëntor 2017: <http://vesti.mk/read/news/5365517/2029572/opozicija-ta-so-shokantni-podatoci-za-smrtta-na-nikola-mladenov>

82 VMRO DPMNE, "SHGM po e përdor retorikën e njëjtë dhe akuzat e njëjta sikurse LSDM/SOROS", Shkup: 2017, 28 nëntor, 2017: <https://vmro-dpmne.org.mk/pres-centar/soopshtenija/znm-ja-koristi-potpolno-istata-retorika-i-istite-lazhni-obvinuvanja-kako-i>

83 VMRO DPMNE, "Naser Selmani gënjen dhe manipulon duke e lidhur VMRO DPMNE-në me sulmin ndaj gazetarëve" Shkup: 2017, qasur më 28 nëntor, 2017: <https://vmro-dpmne.org.mk/pres-centar/soopshtenija/naser-selmani-lazhe-i-manipulira-povrzuvajki-go-vmro-dpmne-so-napadot-na>

84 VMRO DPMNE, "Naser Selmani është e qartë se ka për qëllim që me qëndrimet e tij, të nxisë intolerancë ndëretnike" Shkup: 2014, qasur më 29 nëntor, 2017: <https://vmro-dpmne.org.mk/node/2972>

85 "Llatas: Ti publikojmë të ardhurat tona dhe të shohim se cili është njeri i paguar", Press24.mk, (DATA), 2013. Qasur më 27 nëntor, 2017: <http://press24.mk/latas-ajde-da-gi-objavime-javno-nashite-primanja-pa-davidime-koj-e-platenik>

### **C.3. A funksionon sistemi gjyqësor penal dhe civil në mënyrë efektive me kërcënimet dhe dhunën kundër gazetarëve?**

Institucionet shtetërore dhe aktorët politik në Maqedoni, nuk marrin përgjegjësi që ta sigurojnë ambient të sigurtë për gazetarët. Vetë fakti që deri më tani nuk është zbardhur asnjë rast sulmi ndaj gazetarëve dhe asnjë sulmues nuk është ndëshkuar, flet për qasjen e vërtetë të Qeverisë dhe politikanëve ndaj dukurisë së dhunës mbi gazetarët.

Edhe më shqetësues është fakti se pjesa më e madhe e sulmeve vijnë pikërisht nga përfaqësues të Qeverisë dhe simpatizuesve të tyre.

Qasja e institucioneve dhe e politikanëve ndaj sigurisë së gazetarëve në kontekst pozitiv, u ndryshuar me ardhjen e Qeverisë së re. Qeveria e mëparshme e kryesuar nga VMRO DPMNE-ja, e cila në prill të këtij viti kaloi në opozitë, jo vetëm që nuk mernte përgjegjësi për sigurinë e gazetarëve, por edhe ishte inspirues kryesor i dhunës ndaj gazetarëve. Për 11 vite sa ka qeverisur me shtetin, u instalua një politike e mosndëshkimit të dhunës ndaj gazetarëve. Në vitin e fundit, prej 18 rasteve të ndryshme të sulmeve ndaj gazetarëve, 17 ishin shkaktuar nga funksionarë partiak dhe shtetëror të VMRO DPMNE-së dhe nga funksionarë shtetëror të Bashkimit Demokratik për Integritim. Vetëm në një rast, një aktivist i LSDM-së dhe ish deputet ka lëshuar kërcënime verbale deri tek gazetarët.

Qeveria e mëparshme ishte e shurdhër ndaj thirrjeve të Shoqatës së Gazetarëve që ta ndërpresë dhunën kundër kolegëve. Institucionet shtetërore në shumicën e rasteve injoronin kërkesat e SHGM-së për informata lidhur me hetimin kundër dhunuesve ose sulmuesve të gazetarëve, ndërsa në sakte të theksuara jepeshin përgjigje me të cilat praktikisht, mohoheshin incidentet dhe thuhej ose se nuk kanë ndodhur fare, ose se policia nuk ka arritur që të zbulojë saktësisht se çfarë ka ndodhur.

Ndërrimi i qasjes së institucioneve ndaj sigurisë së gazetarëve, filloi gjatë kohës së Qeverisë teknike të vitit 2016, e cila duhej ti zbatojë zgjedhjet e parakohshme parlamentare. Ministri i atëhershëmi punëve të brendshme nda radhët e BDI-së Agim Nuhiu<sup>86</sup> shfaqti gatishmëri që ti dëgjojë kritikën e SHGM-së dhe të angazhohet në zbardhjen e të gjitha rasteve kundër gazetarëve. Nuhiu në mars të këtij viti, e vizitoi SHGM-në. Dhe informoi se policia ka arritur që ta gjejë sulmuesin e ekipit të portalit A1On dhe ka ngritur procedurë penale për dhunë.

Një dialog paksa më serioz mes SHGM-së dhe policisë ndodhi pas zgjedhjes së Qeverisë së re në qershor të këtij viti. Ministri i ri i Punëve të Brendshme Oliver Spasovski<sup>87</sup> përgatiti një raport të tërë për të gjithë

sulmet kundër gazetarëve, prej të cilave u pa se numri i sulmeve është shumë më i lartë se sa ai i evidencës së SHGM-së. Kjo tregon se gazetarët shumicën e sulmeve i kanë paraqitur vetëm në polici dhe nuk kanë dashur që ti shpërndajnë ato me opinionin dhe SHGM-në.

Megjithatë, raporti i MPB-së nuk kishte emra të gazetarëve të sulmuar, por rastet ishin të shënuara vetëm me inicialet e tyre.

Prandaj, SHGM dërgoi kërkesë të re deri tek policia që të na japë të dhëna shtesë për sulmet që të mund ti fusim në regjistrin tonë. Të dhënat e reja na u dorëzuan në mesin e shtatorit pas çka policia e drejtoi SHGM-në që për informata shtesë ti paraqitet Prokurorisë Publike.

Në Maqedoni për fat të keq, institucionet shtetërore ende nuk kanë zhvilluar politika të veçanta të cilat do të ndihmonin në rritjen e sigurisë së gazetarëve. Madje në institucionet shtetërore të cilat janë përgjegjëse për ndjekjen e gjendjes së sigurisë së gazetarëve, siç është policia, prokuroria dhe gjyqësori, nuk ka mekanizma të veçantë për ndjekjen dhe raportimin e kërcënimeve, frikësimin dhe dhunën ndaj gazetarëve. Në takimin e fundit me ministrin e punëve të brendshme Oliver Spasovski, i cili u mbajt në korrik të këtij viti, u bisedua për mundësinë që policia të mbajë një regjistër të veçantë për sulmet ndaj gazetarëve. Por deri më tani, MPB nuk ka dhënë përgjigje nëse kanë nisur që të zhvillojnë ndonjë regjistër për sulmet mbi gazetarët.

Për të qenë sitata edhe më e keqe, gjykatata dhe prokuroria nuk japin asnjë lloj informatë për lëndët që policia na i dorëzoi për sulmin ndaj gazetarëve.

Për nevojat e këtij raporti, kemi dërguar një kërkesë zyrtare deri tek Gjykata Themelore e Shkupit dhe deri tek Prokuroria Themelore e Shkupit, që të na dorëzojnë të dhëna për lëndët e hapura të dhunës ndaj gazetarëve. Por në vend të përgjigjeve me të dhëna në to, na u dorëzua një letër me shpjegim se informata të tilla nuk mund të na jepen pasi që të sistemin elektronik lëndët ishin të shënuara vetëm me numra e jo edhe me emra, kështu që nuk mund ti ndajnë lëndët që kanë të bëjnë vetëm me sulmet ndaj gazetarëve.

Sulmet ndaj gazetarëve në Maqedoni i regjistron vetëm Shoqata e Gazetarëve të Maqedonisë, e cila për këtë qëllim mban një regjistër të veçantë. Institucionet shtetërore asnjëherë me iniciativën e tyre vetanake nuk kanë publikuar të dhëna për sigurinë e gazetarëve. Përveç kësaj, ata deri më tani kanë qenë shumë të mbyllur për SHGM-në dhe më së shpeshti nuk dëshironin ti jepnin SHGM-së informata për anjë çështje.

Lidhur me lëndët e deritanishme, policia gjatë vitit të fundit ka ngritur procedura në prokurori, por prej këtu është e pamundur që të merren informata se në cilën fazë janë lëndët dhe nëse po veprohet mbi to.

<sup>86</sup> Shoqata e gazetarëve të Maqedonisë, "SHGM kërkoi ndëshkimin e dhunës ndaj gazetarëve", Shkup 2017, qasur më 27 nëntor, 2017. <http://znm.org.mk/?p=3119>.

<sup>87</sup> Shoqata e gazetarëve të Maqedonisë, "MPB ta zbardhë rastin e dhunës ndaj gazetarëve të A1ON", Shkup, 2017, qasur më 27 nëntor, 2017. <http://znm.org.mk/?p=3587>.



Sulmet ndaj gazetarëve ende nuk janë njohur nga Qeveria si sulme ndaj lirisë së shprehjes dhe të drejtave të njeriut. Edhe pse SHGM i inkurajoi funksionarët e Qeverisë që publikisht ti dënojnë sulmet ndaj gazetarëve, deri më tani, vetëm kryeministri Zoran Zaev<sup>88</sup> në një rast, publikisht deklaroi se dhuna ndaj gazetarëve është e papranueshme. Partitë politike<sup>89</sup> vetëm në disa raste të rralla i dënojnë aktet e kërcënimit të sigurisë së gazetarëve.

Deri më tani institucionet nuk kanë miratuar dokumente të veçanta me udhëzime se si policia dhe ushtria duhet të sillen ndaj gazetarëve dhe mediave, ku ata do të paralajmëroheshin se frikësimi, kërcënimet dhe sulmet fizike ndaj gazetarëve janë të ndaluara.

Në vitin 2008 OSBE përgatiti një doracak për punë demokratike të policisë<sup>90</sup>, ku në një kapitull, në mënyrë të shkurtër është trajtuar çështja e raportit të policisë me mediat. Në këtë pjesë mes tjerash, theksohet nevoja e trajnimit të zyrtarëve policorë lidhur me punën e mediave. Megjithatë, deri më tani nuk ka informata se janë mbajtur trajnime të tilla, ose nëse ka procedura të brendshme me të cilat rregullohet raporti i policëve me gazetarët me të cilat do të ndalohej frikësimi, kërcënimet dhe sulmi fizik.

Me Qeverinë e mëparshme të VMRO DPMNE-së, SHGM nuk kishte thuar fare komunikim, pasi që funksionarët shtetëror dhe partiak të kësaj partie, refuzonin vazhdimisht që të takohen me kryesinë e SHGM-së dhe të flasin për problemet e gazetarëve. Arsyeja e vetme për mungesën e komunikimit ishin kritikant që SHGM-ja i adresoi partisë në Qeveri për shkak të politikave të gabuara mediatike të cilat e sollën Maqedoninë në fundin e indeksit të lirisë së shprehjes në Evropë dhe botë.

Qeveria e re tregon interes për bashkëpunim me SHGM-në me qëllim që të tejkalohen problemet me të cilat ballafaqohen gazetarët. Më e rëndësishme se gjithçka është që Qeveria e re ti ndëskojë sulmuesit e gazetarëve, si një parakusht themelor për sigurimin e një ambienti të volitshëm për punën e papenguar të tyre.

Ministri i ri i punëve të brendshme Oliver Spasovski, tregoi iniciativë më të madhe për zbardhjen e shpejtë të sulmeve të reja ndaj gazetarëve, shpejtë idenfitikohen sulmuesit dhe ngriten procedura në prokurori.

Përveç kësaj, për rezultatet e hetimeve i informon përfaqësuesit e SHGM-së. Në qoftë se bashkëpunimi i mirë i kësaj natyre me Qeverinë e re vazhdon, kjo do ti dekurajojë sulmuesit e gazetarëve pasi do tu kujtojë se secila formë e dhunës do dënohet rreptë.

Sistemi juridiko-penal në Maqedoni nuk nuk balafaqohet në mënyrë efikase me kërcënimet dhe aktet e dhunës kundër gazetarëve. Fakti që prej 50 rasteve të dhunës ndaj gazetarëve, në asnjë rast nuk ka patur epilog gjyqësor, asnjë sulmues i gazetarëve nuk është ndëshkuar, kjo tregon qasjen indolente të institucioneve ndaj këtij problemi.

Në institucione nuk ka reparte të veçanta përgjegjëse për hetim, përndjekje dhe mbrojtje të sigurisë së gazetarëve. Nuk ka as procedura që zbatohen për ballafaqim me dhunën e tillë të drejtuar kundër lirisë së shprehjes dhe lirisë së mediave.

Nuk ndahen mjete të veçanta për zbatimin e hetimeve për kërcënimet dhe sulmet ndaj gazetarëve, e as nuk merren masa më serioze si kundërpërgjigje e atyre sulmeve. Thuajse për gjysmën e sulmeve ndaj gazetarëve policia nuk zhvillon fare hetim pasi që rastet nuk kanë qenë të denoncuar, edhe pse për to mediat kanë raportuar vazhdimisht, ndërsa edhe SHGM reagonte tërë kohën. Përveç kësaj, dhjetë përqind e incidenteve të denoncuar policia nuk i ka marrë fare parasysh pasi që gjoja gazetarët nuk kanë dorëzuar informata të mjaftueshme për hetim të mëtejshëm.

Për pesë vitet e fundit, vetëm në një rast MPB e ka njoftuar Prokurorinë për të kërcënim serioz me jetë ndaj një gazetari. Në një rast, SHGM publikisht iu adresua policisë për kërcënimin e sigurisë së gazetarëve të cilët ishin pre e një hajke agresive të mediave proqeveritare të cilat e kanë nxirë imazhin e gazetarëve si tradhëtarë dhe bashkëpunëtor të shërbimeve të huaja sekrete. Asnjë institucion nuk e ka njoftuar SHGM-në ose vetë gazetarët për masat e ndërmarra për garantimin e sigurisë së tyre.

Organet Maqedonase nuk janë në gjendje që në mënyrë efikase ti përndjekin sulmuesit e gazetarëve, ndërsa për përndjekje të organizatorëve ose iniciatorët as që bëhet fjalë.

Për më shumë se 50 sulme ndaj gazetarëve, në bankën e të akuzuarve nuk është ulur asnjë nxitës ose organizator pasi që në shumicën e rasteve ishin të përfshirë funksionarë të lartë shtetëror dhe njerëz të afërt të tyre. Për fat të keq, në disa prej sulmeve ndaj gazetarët ishin kyçur në mënyrë direkte edhe pjesëtarë të policisë, të cilët sipas rregullit, duket të mbrojnë gazetarët. Shteti nuk siguroi asnjë trajnim për pjesëtarët e policisë, prokurorisë, avokatët dhe gjykatësit për rëndësinë e mbrojtjes së lirisë së shprehjes dhe gazetarëve.

88 "(VIDEO) ZAEV: Të dënohen kërcënuesit e ekipit të tv shenja-sroze.cf, 2017", Shenja, 19 qershor, 2017. Qasur më 30 nëntor, 2017: <http://fax.al/read/news/10870778/15433323/zaev-te-denohen-kercenuesit-e-ekipit-te-tv-shenja-s>.

89 "Partitë politike kërkojnë përgjegjësi për kërcënuesit e TV SHENJA". Almakos, 20 qershor, 2017. Qasur më 29 nëntor, 2017: <http://www.almakos.com/video-partite-politike-kerkojne-pergjegjesi-per-kercenuesit-e-tv-shenja>

90 OSBE, Doracak për veprim demokratik të policisë, nga këshilltari i lartë policor i Sekretariatit të Përgjithshëm të OSBE-së, Vjenë: 2008. Qasur më 29 nëntor, 2017: <http://www.osce.org/mk/secretariat/109907?download=true>.

# Shtesë

## Lista e personave të intervistuar

1. Snezhana Trpevska, intervistë me anëtar të ekipit të SHGM-së korrik, 2017
  2. Darko Çekеровski, intervistë me anëtar të ekipit të SHGM-së korrik, 2017
  3. Zoran Fidanovski, intervistë me anëtar të ekipit të SHGM-së korrik, 2017
  4. Gazetar i cili dëshiron të mbetet anonim, intervistë me anëtar të ekipit të SHGM-së korrik, 2017
  5. Mlladen Çadikovski, intervistë me anëtar të ekipit të SHGM-së korrik, 2017
  6. Ivan Bojaxhiski, intervistë me anëtar të ekipit të SHGM-së korrik, 2017
  7. Tamara Çausidis, intervistë me anëtar të ekipit të SHGM-së korrik, 2017
  8. Gazetar i cili dëshiron të mbetet anonim, intervistë me anëtar të ekipit të SHGM-së korrik, 2017
  9. Gazetar i cili dëshiron të mbetet anonim, intervistë me anëtar të ekipit të SHGM-së korrik, 2017
  10. Gazetar i cili dëshiron të mbetet anonim, intervistë me anëtar të ekipit të SHGM-së korrik, 2017
-

## Bibliografi

### Dokumente juridike

1. Gjykata Evropiane për të drejtat e njeriut, Ankesa numër. 67259/14, 09/02/2017, Rasti Selmani dhe të tjetër kundër Republikës së Maqedonisë " qasur më 30 nëntor, 2017: [http://hudoc.echr.coe.int/eng#{"itemid":\["001-170839](http://hudoc.echr.coe.int/eng#{).
2. RTVM, "Kodi etik i gazetarëve të RTVM-së për gazetarët, kuadrot kreative dhe të gjithë të punësuarit në RTVM", Shkup: 2017, qasur më 29 nëntor, 2017: [http://www.mrt.com.mk/sites/default/files/%D0%95%D1%82%D0%B8%D1%87%D0%BA%D0%B8%20%D0%BA%D0%BE%D0%B4%D0%B5%D0%BA%D1%81%20%D0%BD%D0%B0%20%D0%9C%D0%A0%D0%A2\\_0.pdf](http://www.mrt.com.mk/sites/default/files/%D0%95%D1%82%D0%B8%D1%87%D0%BA%D0%B8%20%D0%BA%D0%BE%D0%B4%D0%B5%D0%BA%D1%81%20%D0%BD%D0%B0%20%D0%9C%D0%A0%D0%A2_0.pdf).
3. Ligji për Shërbime mediatike Audio dhe Audiovizuale të Republikës së Maqedonisë. Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë 184/12, 13/14, 44/14, 101/14, 132/14 и 142/16.
4. Ligji për përgjegjësi civile për fyerje dhe shpifje. Gazeta zyrtare e RM-së, 143/2012. <http://www.pravo.org.mk/documentDetail.php?id=6426br.143/2012>
5. Ligji për Media në Republikën e Maqedonisë
6. Ligji për media në Republikën e Maqedonisë. Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë 184/13 и 13/14.

7. Ligji për qasje deri tek informatat me karakter publik, Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë, 13/06, 86/08, 6/10, 42/14, 148/15, 55/16.
8. Kodi zgjedhor i Republikës së Maqedonisë.
9. Kushtetuta e Republikës së Maqedonisë. Kushtetuta ishte sjellë dhe miratuar nga ana e Kuvendit të Republikës së Maqedonisë më 17 nëntor të vitit 1991 në Shkup. I publikuar në “Gazetën Zyrtare të RM-së”, numër 52 dhe 22, viti 1991. Pjesë përbërëse e Kushtetures janë Amendamentet 1 dhe 2, të publikuara në “Gazetën Zyrtare të RM-së”, numër. 31 më 02 korrik viti; Amendamentet 4 deri 13, të publikuara në “Gazetën zyrtare të RM-së” numër 91, më 20 nëntor të vitit 2001; Amendamenti 19, i publikuar në “Gazetën zyrtare të RM-së” numër 84 më 30 dhjetor të vitit 2003.

## Publikime

1. ATSHAA, Analizë e tregut të shërbimeve audio dhe audiovizuale për vitin (Shkup: ATSHAA, 2017), qasur më 27 nëntor, 2017: [http://avmu.mk/wp-content/uploads/2017/05/Analinaliza\\_na\\_pazarot\\_ns\\_sudio\\_i\\_audiovizuelni\\_mediumski\\_uslugi\\_za\\_2016\\_godina.-min.pdf](http://avmu.mk/wp-content/uploads/2017/05/Analinaliza_na_pazarot_ns_sudio_i_audiovizuelni_mediumski_uslugi_za_2016_godina.-min.pdf).
2. OSBE, Doracak për veprim demokratik të policisë nga këshilltari i lartë policor i OSBE-së, Vienë: 2008. Qasur më 29 nëntor, 2017: <http://www.osce.org/mk/secretariat/109907?download=true>.
3. Nebiu.B, Selmani.N, Sekulovski.D, 2017, Indikatorë për nivelin e lirisë së mediave dhe për sigurinë e gazetarëve [MAQEDONI].
4. Freedom House, Profil i Maqedonisë – Liria e mediave 2017, qasur më 29 nëntor, 2017: <https://freedomhouse.org/report/freedom-press/2017/macedonia>.

## Dokumente për politikë

1. Marrëveshja e Përzahinos. Qasur më 21 nëntor të vitit 2017: <https://www.mkd.mk/makedonija/politika/dujgo-objavi-celosniot-dogovor-na-liderite-od-2-juni>.
2. Rajhard Pribe, dhe të tjerë, Ish Republika Jugosllave e Maqedonisë: Rekomandime të ekspertëve të lartë. Bruksel 8 qershor, 2015: [https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/sites/near/files/news\\_corner/news/news-files/20150619\\_recommendations\\_of\\_the\\_senior\\_experts\\_group.pdf](https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/sites/near/files/news_corner/news/news-files/20150619_recommendations_of_the_senior_experts_group.pdf).
3. OSBE, Ish Republika Jugosllave e Maqedonisë-Zgjedhjet e parakohshme parlamentare të 11 dhjetorit, viti 2016– Misioni mbikqyrës i zgjedhjeve të OSBE-ODIHR. Varshavë: 2017, më 19. Qasur më 29 nëntor, 2017: <http://www.osce.org/mk/odihrelections/fyrom/302261?download=true>.
4. Qeveria e Republikës së Maqedonisë, Plani 3-6-9. Qasur më 21 nëntor, 2017: <http://www.sep.gov.mk/data/file/Dokumenti/Plan%203-6-9%20MK.pdf>.

## Tekste online

1. Agjencia për shërbime audio dhe audiovizuale, Letër deri tek RTVM-ja, Shkup: 3 Maj 2017, qasur më: 27 nëntor, 2017: [http://trinity.mk:53000/wp-content/uploads/2017/05/Dopis\\_do\\_Programski\\_sovet\\_na\\_MRT.pdf](http://trinity.mk:53000/wp-content/uploads/2017/05/Dopis_do_Programski_sovet_na_MRT.pdf).
2. “Agjencia e Mediave konstatoi gjuhë të urrejtjes në televizionin Sitel”, Ako.mk, Për herë të fundit ndryshuar më 21 nëntor, 2017: <http://ako.mk/%D0%B0%D0%B3%D0%B5%D0%BD%D1%86%D0%B8%D1%98%D0%B0-%D0%B7%D0%B0-%D0%BC%D0%B5%D0%B4%D0%B8%D1%83%D0%BC%D0%B8-%D0%BA%D0%BE%D0%BD%D1%81%D1%82%D0%B0%D1%82%D0%B8%D1%80%D0%B0%D1%88%D0%B5-%D0%B3%D0%BE%D0%B2/>.
3. Viktor Dano, “Thyhen shtiza për rregullimin e mediave online dhe bllogerëve” It.mk, 21 janar, 2016. Qasur më 30 nëntor, 2017: <https://www.it.mk/se-krshat-kopja-za-regulirane-na-onlajn-mediumite-i-blogerite/>.
4. Qeveria e Republikës së Maqedonisë. “Qeveria e mëparshme ka harxhuar 38 milion euro për fushatë mediatike dhe për hulumtimin e mendimin publik”. Qasur më 21 nëntor, 2017: <http://vlada.mk/node/13464>.

5. VMRO-DPMNE, "SHGM e përdor krejtësisht të njëjtën retorikë dhe akuzat e njëjta sikurse LSDM/SOROS", Shkup: 2017, 28 nëntor, 2017: <https://vmro-dpmne.org.mk/pres-centar/soopshtenija/znm-ja-koristi-potpolno-istata-retorika-i-istite-lazhni-obvinuvanja-kako-i>
6. VMRO DPMNE, "Naser Selmani gënjen dhe manipulon kur e lidhë VMRO DPMNE-në me sulmet ndaj gazetarëve", Shkup: 2017, qasur më 28 nëntor, 2017: <https://vmro-dpmne.org.mk/pres-centar/soopshtenija/naser-selmani-lazhe-i-manipulira-povrzuvajkji-go-vmro-dpmne-so-napadot-na>.
7. VMRO DPMNE, "Naser Selmani është e qartë se ka për qëllim që me qëndrimet e tij të shkaktojë mungesë tolerance ndëretnike", Shkup: 2014, qasur më 29 nëntor, 2017: <https://vmro-dpmne.org.mk/node/2972>.
8. Defo Daniell, "Karaxhovski: PSP është infantile, gazetarët janë të njëanshëm", Zhurnal.net, 1 shkurt, 2017. Qasur më 29 nëntor, 2017: <http://zurnal.net/?tag=%D0%B7%D0%BE%D1%80%D0%B0%D0%BD-%D0%BA%D0%B0%D1%80%D0%B0%D1%9F%D0%BE%D0%B2%D1%81%D0%BA%D0%B8>
9. "(INTEGRALE) Gjithë raporti i Rajhard Pribesë për krimin, korrupsionin dhe përgjimin" Lokallno, 19 qershor, 2015, qasur: 27 nëntor, 2017, <http://lokalno.mk/integralnoceliot-izveshtaj-na-rajnhard-pribe-za-kriminalot-korupcijata-i-prislushuvanjetona-vlasta/>.
10. "Si ka arritur të ngulfatet në kovë", Veçer, 24 qershor, 2008. Qasur më 27 nëntor, 2017: <http://vecer.mk/kako-uspeal-da-se-udavi-vo-kofa>.
11. "Llatas: ti publikojmë të ardhurat tona e pastaj të shohim se kush është i paguar", Press24.mk, (data), 2013. Qasur më 27, 2017: <http://press24.mk/latas-ajde-da-gi-objavimejavno-nashite-primanja-pa-da-vidime-koj-e-platenik>.
12. "Ligji për media: Gazetarët të ndarë në qëndrime për çështjen se kush është gazetar", Telegraf.mk. 30 korrik, 2016, qasur më 27 nëntor, 2017: <http://www.telegraf.mk/aktuelno/makedonija/ns-newsarticle-19945-zakon-za-mediuminovinarite-se-podelija-za-prasanjeto-koj-e-novinar.nspk>.
13. Shoqata e gazetarëve të Maqedonisë," SHGM i dënon sulmet dhe kërcënimet ndaj gazetarëve të tv24Vesti dhe Portalb", Shkup, 2017 qasur më 27 nëntor, 2017: <http://znm.org.mk/?p=3392>.
14. Shoqata e gazetarëve të Maqedonisë ,"Dënojmë sulmin verbal të Qeverisë ndaj gazetarëve", Shkup 2017, qasur më 27 nëntor, 2017: <http://znm.org.mk/?p=2924>.
15. Shoqata e gazetarëve të Maqedonisë, "Dënojmë ashpër kërcënimet me jetë ndaj Triçkovskit", Shkup, 2017, qasur më 27 nëntor, 2017: <http://znm.org.mk/?p=3413>.
16. Shoqata e gazetarëve të Maqedonisë, "SHGM dënon sulmin verbal ndaj gazetarëve të TV VIS në komunën Novo Sellë", Shkup, 2017 qasur më 27 nëntor, 2017: <http://znm.org.mk/?p=3592>
17. Shoqata e gazetarëve të Maqedonisë, "Dënojmë kërcënimet e simpatizuesve të BDI-së ndaj televizionit Shenja", Shkup, 2017 qasur më 27 nëntor, 2017: <http://znm.org.mk/?p=3573>
18. Shoqata e gazetarëve të Maqedonisë, "SHGM i dënon sulmet dhe kërcënimet ndaj gazetarëve të tv24 dhe Portalb", Shkup, 2017, qasur më 27 nëntor, 2017: <http://znm.org.mk/?p=3392>
19. Shoqata e gazetarëve të Maqedonisë, "Dënojmë kërcënimet e Rahiç kundër gazetarëve", Shkup, 2017, qasur më 27 nëntor, 2017: <http://znm.org.mk/?p=3026>
20. Shoqata e gazetarëve të Maqedonisë, "Dënojmë kërcënimet e ministrit Ahmeti ndaj gazetarit Mislimi", Shkup, 2017 qasur më 27 nëntor, 2017: <http://znm.org.mk/?p=2679>
21. "Sulm ndaj Borjan Jovanovskit", YouTube, për herë të fundit është ndryshuar më 2 mars të vitit 2017: [https://www.youtube.com/watch?v=p-Gp0FWNW\\_4](https://www.youtube.com/watch?v=p-Gp0FWNW_4)
22. Shoqata e gazetarëve të Maqedonisë, "Peshevski ose të japë dorëheqje ose ta shkarkojnë",Shkup, 2016, qasur më 27 nëntor, 2017: <http://znm.org.mk/?p=2776>
23. Shoqata e gazetarëve të Maqedonisë, "SHGM kërkon ndëshkrimin e dhunës ndaj gazetarëve", Shkup, 2017, qasur më 27 nëntor, 2017: <http://znm.org.mk/?p=3119>.
24. Shoqata e gazetarëve të Maqedonisë, "MPB ta zbardhë rastin e dhunës ndaj gazetarëve të A1 On", Shkup, 2017, qasur më 27 nëntor, 2017: <http://znm.org.mk/?p=3587>.
25. Shoqata e gazetarëve të Maqedonisë, "Fitoi drejtësia për gazetarët në Strazbur", Shkup, 2017, qasur më 27 nëntor, 2017: <http://znm.org.mk/?p=2998>.

26. Shoqata e gazetarëve të Maqedonisë, “Thirje deri tek gazetaët që të padisin për dhunën në Kuvend”, Shkup, 2017, qasur më 27 nëntor, 2017: <http://znm.org.mk/?p=3245>.
27. Shoqata e gazetarëve të Maqedonisë: [http://znm.org.mk/?page\\_id=719&lang=en](http://znm.org.mk/?page_id=719&lang=en).
28. Shoqata e gazetarëve të Maqedonisë, “SHGM siguroi kodin etik për mediat në Maqedoni”, Shkup, 2017, qasur më 27 nëntor, 2017: <http://znm.org.mk/?p=3776>.
29. Shoqata e gazetarëve të Maqedonisë, “Të shtyhet sjellja e kodit etik të RTVM-së”, Shkup, 2017, qasur më 27 nëntor, 2017: <http://znm.org.mk/?p=3102>.
30. Shoqata e gazetarëve të Maqedonisë, “SHGM: Të mos raportohet nga protesta të dhunshme”, Shkup, 2017, qasur më 27 nëntor, 2017: <http://znm.org.mk/?p=3043>.
31. Shoqata e gazetarëve të Maqedonisë, “Sulmi ndaj Bellovskit është i orkestruar nga struktura të MPB-së”, Shkup, 2017 qasur më 27 nëntor, 2017: <http://znm.org.mk/?p=2754>
32. Shoqata e gazetarëve të Maqedonisë, “Dënojmë sulmin ndaj gazetarit Barllakovski”, Shkup, 2017, qasur më 27 nëntor, 2017: <http://znm.org.mk/?p=3195>
33. Shoqata e gazetarëve të Maqedonisë, “Dënojmë sulmin ndaj ekipit të NOVA TV” Shkup, 2017, qasur më 27 nëntor, 2017: <http://znm.org.mk/?p=3678>.
34. “SHGM përshëndeti gjetjet e monitoruesve ndërkombëtar të mediave”, MKD:MK, 13 dhjetor 2016, qasur më 27 nëntor, 2017: <https://www.mkd.mk/makedonija/politika/zn-m-gi-pozdravi-naodite-na-megjunarodnite-nabljuduvachi-za-mediumite>.
35. Maruliç Jakov Simona, “Gazetarët e Maqedonisë do ta kërkojnë drejtësinë në Strazbur”, Balkan Inside, 5 qershor, viti 2014, qasur më 27 nëntor, 2017: <http://www.balkaninsight.com/en/article/macedonia-journalists-to-seek-justice->.
36. “Të rinjtë deri te Triçkovski: Si nuk ke turp, tradhëtar!”, YouTube, Për herë të fundit ndryshuar më 1 mars, 2017: <https://www.youtube.com/watch?v=4L6glPy4PNI>.
37. “Prokuroria e mbylli rastin Mlladenov si aksident” 24vesti, 10 korrik, 2013, qasur më 27 nëntor, 2017: <http://24vesti.mk/obvinitelstvoto-go-zatvori-sluchajot-mladenov-kako-nesrekja>.
38. “Opozita me të dhëna shokuese për vdekjen e Mlladenovit”, Faktor, 7 maj, 2015. Qasur më 27 nëntor, 2017: <http://vesti.mk/read/news/5365517/2029572/opozicijata-so-shokantni-podatoci-za-smrtta-na-nikola-mladenov>.
39. “Gazetari Nikolla Mlladenov humbi jetën në një aksident rrugor”, MKD:MK, 27 mars, 2013, qasur më 27 nëntor, 2017: <https://www.mkd.mk/crna-hronika/poznatiot-novinar-nikola-mladenov-zagina-vo-soobrakajna-nesrekja>.
40. “Ekipi i komisionit AD-Hok tashmë është i njohur”, Fokus, 9 gusht, 2016, qasur më 27 nëntor, 2017: <http://vecer.mk/makedonija/poznat-sostavot-na-ad-hok-teloto>.
41. “Santa Argirova është kryeredaktorja e re e redaksisë informative të RTVM-së”, Fokus, 31 gusht, 2016, qasur më 27 nëntor, 2017: <http://fokus.mk/santa-argirova-nov-urednik-na-informativnata-programa-na-mtv/>.
42. LSGM: <http://ssnm.org.mk/?lang=en>.
43. LSGM, “Rroga në media e bllokuar nën mesataren”, Shkup, 2017, qasur më 27 nëntor, 2017: <https://ssnm.org.mk/%D0%BF%D0%BB%D0%B0%D1%82%D0%B0%D1%82%D0%B0%D0%B2%D0%BE-%D0%BC%D0%B5%D0%B4%D0%B8%D1%83%D0%BC%D0%B8%D1%82%D0%B5-%D0%B7%D0%B0%D0%B3%D0%BB%D0%B0%D0%B2%D0%B5%D0%BD%D0%B0-%D0%BF%D0%BE%D0%B4-%D0%BF%D1%80/>.
44. LSGM, Karta për raportim etik gjatë zgjedhjeve, Shkup, 2017, qasur më 27 nëntor, 2017: <http://semm.mk/novosti-4/2015-08-11-15-03-18/499-povelba-za-etichko-izvestuvanje-za-izborite>.
45. “(VIDEO) ZAEV: Të dënohen kërcënuesit e ekipit të tv shenja-sroze.cf, 2017”, Shenja, 19 qershor, 2017. Qasur më 30 nëntor, 2017: <http://fax.al/read/news/10870778/15433323/z-aev-te-denohen-kercenuesit-e-ekipit-te-tv-shenja-s>.
46. “Partitë politike kërkojnë përgjegjësi për kërcënuesit e TV SHENJA”. ALMAKOS, 20 korrik, 2017. Qasur më 29 nëntor, 2017: <http://www.almakos.com/video-partite-politike-kerkojne-pergjegjesi-per-kercenuesit-e-tv-shenja>.



